



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 11 dhe 12 nëntor 2019.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” (*komision për dhënie mendimi*)

Seancë dëgjimore me Prokurorinë e Përgjithshme.

Seancë dëgjimore me Gjykatën Kushtetuese

Seancë dëgjimore me Shkollën e Magjistraturës

Seancë dëgjimore me Këshillin e Lartë Gjyqësor

Seancë dëgjimore me Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Seancë dëgjimore me Kolegjin e Posaçëm të Apelit

Seancë dëgjimore me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

Seancë dëgjimore me Komisionerët Publikë

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Aurora Mara, Elda Hoti, Elena Xhina, Andi Përmeti, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Ediola Braha, Adriatik Alimadhi dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Alma Muça – përfaqësuese nga Prokuroria e Përgjithshme

Luan Abazi – përfaqësuese nga Prokuroria e Përgjithshme

Vilma Causholli - Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave

Eugen Papandile – Sekretar i Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese

Ela Qokaj – Kancelare në Shkollën e Magjistraturës

Alketa Havari - Përgjegjëse e Sektorit të Financës në Shkollën e Magjistraturës

Naureda Llagami – Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Maksim Qoku – Zevendes kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Luljeta Laze – Përfaqësuese e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Rudin Baqli – Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Gent Ibrahim – Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Gjon Ndreja – Këshilltar ekonomik i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Ilirjana Nano – Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Natasha Mulaj - Kryetare në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

Genta Tafa (Bungo)- Kryetar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Agim Paskali – Drejtor Ekonomik i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Albana Pulaj- Drejtoreshë Juridike e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Florian Ballhysa - Komisioner Publik

Darjel Sina - Komisioner Publik

Alketa Çeli – Kancelare

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Media mund të hyjë.

Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës. Fillimisht kemi miratimin e procesverbaleve të datave 11 dhe 12 nëntor 2019 të Komisionit të Ligjeve.

Ka vërejtje për procesverbalet nga kolegët e komisionit? Nuk ka.

Miratojen procesverbalet e datave 11 dhe 12 nëntor 2019 të Komisionit të Ligjeve.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Bashkim Fino.

Projektbuxheti i vitit 2020 u prezantua në mbledhjen e kaluar në parim nga ministrja e Financave dhe, siç është traditë tashmë, Komisioni i Ligjeve, para votimit të projektbuxhetit zhvillon dëgjesa me institucionet kushtetuese apo të krijuara me ligj dhe të tjera, që janë në fushën e përgjegjësisë së komisionit. Sot do të jetë një ditë e gjatë. Dëgjesat me institucionet janë të ndara në dy grupe.

Sot kemi grupin e parë të institucioneve, ndaj u kërkoj kolegëve që sot të përgatiten për një seancë që mund të zgjasë deri rreth orës 14:00.

Do ta nisim me seancën dëgjimore me institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme. Do të kërkoja nga përfaqësuesit e institucioneve të prezantohen edhe për funksionin që kanë, kur të marrin fjalën.

Nga Prokuroria e Përgjithshme ka konfirmuar pjesëmarrjen zonja Alma Muça, të cilën nuk e shikoj prezente sot, në fakt, si dhe zoti Luan Abazi, si përherë, që vjen dhe mbron buxhetin në Komisionin e Ligjeve.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë sot për gjatë gjithë ditës me ne në komision do të jetë zonja Vilma Çausholli, përgjegjëse e sektorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit. Zonja Çausholli është prezente sot në komision.

Zoti Fino, jemi gati? Fillojmë pa humbur kohë me institucionin e parë, që është Prokuroria e Përgjithshme.

Zoti Abazi, ju, gjatë kohës së hartimit të projektbuxhetit të vitit 2020, keni qenë në kontakt me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Cilat kanë qenë nevojat buxhetore? Sa

janë akomoduar ato në projektbuxhetin e vitit 2020 dhe çfarë suporti kërkoni sot nga Komisioni i Ligjeve?

Më pas, zoti Fino, si relator, jam i bindur që ka realizuar me përpikmëri nevojat buxhetore që kishit ju për vitin 2019 dhe si i keni shpenzuar dhe akomoduar ato.

Sot do të shikojmë çfarë do të marrim në konsideratë nga ato që keni parashtruar ju në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Fjala për ju.

Luan Abazi – I nderuar, zoti kryetar!

Bazuar në ligjin për menaxhimin financiar, ligjin e buxhetit të shtetit, Prokuroria e Përgjithshme ka përgatitur programin buxhetor afatmesëm, i cili është bërë pjesë strukturore e projektbuxhetit të vitit 2020 nga Ministria e Financave. Nisur nga tavanet buxhetore, që janë orienutes për çdo institucion buxhetor, në kërkesat e vitit 2020 Prokuroria e Përgjithshme ka pasur nevoja shtesë. Nëse i referohemi shifrave të projektbuxhetit, në zëra të veçantë jemi me ulje. Nëse fondi i pagave është ai që i përket numrit të punonjësve, për vitin 2020 është menduar që Prokurorisë së Përgjithshme t'i shkurtohen 60 punonjës. Ne nuk jemi dakord me këtë pakësim, sepse duhen parë të gjitha ligjet në tërësi për sistemin e prokurorisë, përfshirë edhe ligjin për Policinë Gjyqësore.

Problematikë tjetër për këtë projektbuxhet është ulja e shpenzimeve operative në masën 60 milionë, e cila na vendos në vështirësi për vitin që vjen.

Për sa u përket investimeve, Ministria e Financave ka menduar të jenë në masën 130 milionë, kurse ne, në shtesat që kemi argumentuar, kërkojmë 650 milionë. Kjo shtesë në masën pesëfish nga tavani buxhetor mendoj se duhet të negociohet me Ministrinë e Financave dhe me Komisionin tuaj të nderuar, sepse shkon për përmirësimin e sistemeve që ka në përdorim Prokuroria e Përgjithshme dhe kryesisht për sistemin e përgjimit.

Kërkesat që ne kemi duhet të merren në konsideratë nga ana juaj për të pasur një ecuri normale të institucionit për vitin 2020 dhe në vijim.

Shtesat për investimet nuk po i lexoj, sepse janë shumë specifike, por mendoj që në një kontakt, që mund të kemi, mund të sqarohemi edhe më mirë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Abazi!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Në lidhje me projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme, për mua nuk qëndrojnë të gjitha këto që tha përfaqësuesi i prokurorisë, me përjashtim të investimeve, ku do të bëj një argument.

Heqja e 60 personave, sipas rakordimit që kemi bërë që në fillim, ka të bëjë me krijimin e SPAK-ut. Çfarë ndodh? Do të hiqen rreth 60 persona nga Prokuroria e Përgjithshme, që do të largohen te SPAK-u. Këta 60 persona që ikin nga Prokuroria e Përgjithshme ikin edhe me fondin e pagës dhe të gjitha shpenzimet, zoti kryetar. Këta thonë se meqenëse do të ikin këta për SPAK-un, kërkojmë njerëz të tjerë. Po të shikoni evidencën, në projektbuxhetin e vitit 2029 kanë qenë 928 persona. Duke hequr 60 persona, do të ngelen 868. Kjo është çështje tjetër që kërkojnë këta. Pra, këta 60 persona, që ikin, shkojnë për krijimin e një sektori të ri.

Po ta shikojmë projektbuxhetin si fond page, është mëse i realizueshëm dhe shumë herë më i madh nga projektbuxheti i vitit 2019. Pra, nga 1 milionë e 750 që është fondi i pagës shkon në 2 milionë e 328 mijë, pavarësisht se do të ikin 60 persona.

E dyta, për shpenzimet dhe mallrat. Më vjen keq, por ju duhet t'i shikoni dhe t'i kuptoni shifrat në tërësinë e tyre. Kur vini këtu, duhet të raportoni, të thonë: ne kemi pasur këto shpenzime dhe ne i kemi realizuar. Evidencat që kam unë, që mund t'i keni edhe ju, por janë të detajuara në librin e madh, janë të të gjitha viteve, duke filluar nga viti 2013, të cilat nuk po i lexoj. Po lexoj projektbuxhetin e vitit 2019. Po lexoj faktikun e vitit 2019 për 10-mujorin e parë, sa është realizuar tashmë me atë që kemi dhënë në vitin 2019 dhe atë që mendojmë ne apo Ministria e Financave për të dhënë në vitin 2020.

Çfarë rezulton te shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve? Në vitin 2019 kanë pasur 349,9 milionë lekë shërbime dhe mallra, të famshmin 602, në mos gaboj. Po të shikoni, në 10-mujor, këta kanë realizuar 238 milionë nga 349 milionë. Pra, ka një diferencë shumë të madhe të mosrealizimit të shërbimeve dhe mallrave. Ndërkohë, përllogaritja nga Ministria e Financave është që në vitin 2020 të ketë 290 milionë lekë për shërbime dhe mallra, për të cilën unë mendoj se janë të mjaftueshme.

Për investimet nuk mund të flas, sepse për vitin 2019 ju kishit planifikuar 130 milionë lekë, ndërkohë që këta kanë realizuar vetëm 2,3 milionë. Domethënë, në vitin 2019 ju kemi dhënë 130 milionë. U kemi thënë: investoni. Ata nuk kanë investuar 130 milionë, por 2,3 milionë. Tani thonë se nuk duan 130 milionë, që keni parashikuar, por kërkojnë 650 milionë. Për këtë vit ju kemi dhënë 130 milionë dhe keni realizuar vetëm 2,3 milionë. Si mund t'ju japim tani 650 milionë, kur nuk keni realizuar investimet e këtij viti? Çfarë dua të them me këtë argumentim, më tepër teknik-financiar? Dua të them se shifrat e paraqitura këtu janë të mjaftueshme për të zhvilluar aktivitetin, që Prokuroria e Përgjithshme të ecë përpara për sa i përket argumentit që ngriti për Policinë Gjyqësore, që mund të jetë një çështje ligjore, natyrisht, kur të bëhet ligji dhe, në mos gaboj, e kemi ligjin këtu për ta diskutuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është bërë.

Kjo është një çështje që duhet rakorduar me Ministrinë e Financave se unë nuk mund të them sa do të punojnë nga Policia Gjyqësore, por 60-shja ikën me gjithë SPAK-un, me fondin e pagave, me shpenzimet dhe nuk ka punë Prokuroria e Përgjithshme. Kjo pastaj është një çështje teknike, se si mund ta zgjidhë Ministria e Financave dhe mund ta trajtojë përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Braho.

Spartak Braho –Të kemi një situatë më të qartë. Ndryshe relatton zoti Fino (dhe unë jam i bindur që ashtu është), ndryshe janë kërkesat atje. Na thoni se si është e vërteta. Ku përplaseni? Se nga 200 e ca milionë lekë investime, ju realizoni 2 milionë. Kjo është kujë e zezë!

Ulsi Manja – Po, zoti Abazi.

Luan Abazi – Shifra si 10-mujor është e saktë. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe, që nga mbarimi i 10-mujorit e në vijimësi, të gjitha fondet janë prokuruar, me përjashtim të një 40-milionëshi, që i përket rikonstruksionit dhe është shtesë kati në prokurorinë e Gjirokastrës. Kjo ka ardhur si rezultat i mosmarrëveshjes për pronësinë midis Ministrisë së Drejtësisë dhe prokurorisë. Ministria e Drejtësisë nuk na ka lejuar të bëjmë shtetën e katit mbi godinën aktuale. Është në negociatë, por nuk mund të themi se do të zgjidhet për këtë vit, për më tepër që jemi në fund të vitit buxhetor. Gjykojmë dhe është e domosdoshme që në prokurorinë e Gjirokastrës të ketë shtesë kati, për arsye se kushtet e punonjësve janë minimale. Nuk kemi hapësira, nuk kemi vend për të punuar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Abazi!

A ka të tjera pyetje?

Zoti Fino, përfundimisht, si relator...

Ministria e Financave, a jeni dakord ne zotin Fino?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Shifrat që janë këtu janë të sakta dhe vetë përfaqësuesi i prokurorisë i pranoi. Të vetmen gjë që nuk mund ta them dot nga pikëpamja profesionale është çështja e Policisë Gjyqësore, e cila duhet të shikohet midis prokurorisë dhe Ministrisë së Financave. Në qoftë se këta vërtet thonë se do të shtohen, se është ligji, dhe u duhet një numër i konsiderueshëm, këtë mund të shikojë Ministria e Financave nga fondi rezervë për ta shtuar si numër. Në momentin kur shtohet si numër, të jeni të sigurt që fondi rezervë e ka edhe pjesën e

fondit financiar dhe nuk ka problem, ndërsa shifrat e tjera të ngelen siç janë, sepse janë shumë korrekte dhe nuk ka arsye për të bërë ndonjë ndryshim tjetër. Kështu them unë, gjithsesi, atë e dini ju.

Ulsi Manja – Dakord, zoti Fino.

Në fakt, ligji për Policinë Gjyqësore është në fuqi dhe po zbatohet. Në ligj është përcaktuar që numri i oficerëve të Policisë Gjyqësore përcaktohet nga Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Ka një numër sot të oficerëve të Policisë Gjyqësore në shkallë republike.

Vazhdimisht, Prokuroria e Përgjithshme e ka ngritur si shqetësim në komision shtimin e numrit të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Vjet pati një shtim të numrit të oficerëve. Në mos gaboj, u kërkuan 60 dhe u miratuan 30 oficerë të Policisë Gjyqësore, 6 nga të cilët në sektorin e dekriminalizimit. Gjithsesi, jam dakord me zotin Fino. Nëse pas rakordimit mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë do të ketë një shtim të numrit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, jam plotësisht dakord që Ministria e Financave të ulet me Prokurorinë e Përgjithshme dhe të akordojë fondin shtesë në zërin buxhetor përkatës.

A jeni dakord, kolegë?

Zoti Abazi...

Luan Abazi – Zoti kryetar, përveç numrit të oficerëve (bëhet fjalë për oficerët e Prokurorisë për Krimet e Rënda, të cilët punojnë atje aktualisht), është edhe numri i prokurorëve. Numri i prokurorëve në gjithë sistemin e prokurorisë është i miratuar me dekretin e Presidentit të Republikës dhe është 336. Numri i prokurorëve për Prokurorinë e Posaçme është më vete. Shkurtimi me 60 veta do të ndikojë edhe në numrin e prokurorëve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Abazi!

Kam një sqarim për kolegët, sepse jam në dijeni të kësaj situate. Nuk ndajmë të njëjtin mendim, sepse prokuroria e SPAK-ut është prokurori karriere dhe është menduar që prokurorët, që vijnë nga kjo strukturë, të vijnë nga brenda radhëve të prokuroreve që ka sot në numrin e përgjithshëm të prokurorëve. Gjithsesi, numrin e prokurorëve në shkallë republike, qoftë në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm, qoftë në prokurorinë e SPAK-ut, që është i njëjti numër i përcaktuar me dekretin e Presidentit, nëse Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të gjykojë, nisur nga ngarkesa dhe volumi i punës që ka sot sistemi i prokurorisë, ta shtojë, patjetër, në një moment të caktuar do t'i akomodojmë edhe nevojat buxhetore. Çështja e numrit është e mbyllur. Prokurorët e SPAK-ut janë brenda numrit të përgjithshëm të prokurorëve që ka sot sistemi.

Faleminderit, zoti Abazi!

Gjatë këtyre ditëve, derisa buxheti të votohet në parim në Kuvend, ju ftoj të jeni në kontakt me Ministrinë e Financave dhe zotin Fino.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Institucioni i dytë në radhë është Gjykata Kushtetuese.

Nga Gjykata Kushtetuese do të kemi prezent sekretarin e Përgjithshëm, zotin Eugen Papandile.

Zoti Papandile, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Gjykata Kushtetuese përherë i ka pasur kërkesat modeste për buxhetin në Komisionin e Ligjeve.

Shumë shkurtimisht do të donim të dinim se çfarë nevojash keni parashtruar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe sa janë marrë në konsideratë nevojat buxhetore për vitin 2020. Pastaj relatori dhe kolegët e mi të komisionit janë të hapur për të akomoduar kërkesat që realisht janë të pranueshme.

Fjala është për ju.

Eugen Papandile – Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Gjykata Kushtetuese për vitin 2020 ka pasur kontakte të herëpashershme me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave.

Po e filloj me zhgënjimin që kemi ndaj buxhetit të akorduar këtë vit, pasi është ulur nga tavani i dakordësuar më parë. Janë ulur 3 milionë lekë të rinj, që në dukje mbase është një shifër modeste, por Gjykatës Kushtetuese i bën punë. Pra, nga shpenzimet operative na kanë hequr 3 milionë lekë të rinj.

Për sa u përket investimeve, nuk po zgjatëm shumë në shifra (si jurist, nuk i kam shumë qejf), por gjithsesi po ju paraqes disa nga kërkesat që Gjykata Kushtetuese ia ka bërë me dije dhe ia ka adresuar Ministrisë së Financave.

Kërkesa e parë është shumë e vjetër dhe nuk është marrë parasysh. Jemi në po të njëjtën godinë, ku jeni edhe ju, të nderuar ligjvënës, dhe ambientet e Gjykatës Kushtetuese (e vetmja që ka mbetur pa u rikonstruktuar në këtë godinë) janë tashmë të amortizuara, të goditura për së dyti edhe nga dukuria natyrore e tërmetit. Mendojini kushtet në të cilat anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese kanë filluar punën dhe do të vazhdojnë të punojnë aty. Pra, e kemi kërkuar dhe nuk është na është miratuar kërkesa për rikonstruksionin.

Duhet pasur parasysh se fluksi (ndërkohë Gjykata Kushtetuese ka një numër të caktuar anëtarësh për të filluar funksionimin e mirë të saj, mbledhja e gjyqtarëve në vitin 2017 ka

miratuar 72 punonjës të kësaj gjykate dhe tashmë jemi 62, pasi 10 të tjerët që kemi kërkuar nuk na janë miratuar) do të ndikojë në keqfunksionimin e mëtejshëm të Gjykatës Kushtetuese, duke marrë parasysh çështjet e shumta me të cilat do të përballlet Gjykata Kushtetuese, duke vazhduar pastaj me parkun e makinave, që nuk është rinovuar prej vitesh, si dhe disa investime të tjera, që mendoj të mos i trajtoj këtu, por Ministria e Financave i ka kërkesat tona formale dhe zyrtare për to.

Kaq ishte shkurtimisht.

Ju falënderoj!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Papandile!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Faleminderit, zoti sekretar i Përgjithshëm!

Mendoj se projektbuxheti i Gjykatës Kushtetuese është në rritje, është i qëndrueshëm dhe i mjaftueshëm për të realizuar aktivitetin.

Më lejoni t'ju them vetëm dy shifra për të kuptuar se pse është në rritje.

Te buxheti i vitit 2019 totali i shpenzimeve është 114,7 milionë lekë. Në projektbuxhetin e 2020-s ne japim 161 milionë lekë, pra kemi goxha rritje.

Tani, marrim mallrat dhe shërbimet, ku ju keni probleme dhe i trajtuat.

Në buxhetin e 2019-s kanë qenë 34,5 milionë lekë. Në fakt, në këtë 10-mujor, kjo gjykatë ka harxhuar vetëm 17 milionë lekë, pra vetëm gjysmat. Nuk besoj se do të harxhohen gjysmat për 2 muaj dhe nuk ka mundësi të harxhohen. Me të drejtë, Ministria e Financave ka parashikuar 31,5 milionë lekë për mallra dhe shërbime për vitin 2020, pra ka një rënie prej 3 milionësh, siç thatë dhe ju, por duke parë ecurinë e gjykatës dhe të këtyre shpenzimeve, se ne nuk e bëjmë kot tabelën e 10-mujorit, mendoj se është e pranueshme.

Për sa u përket investimeve, unë jam kundër dhënies së investimeve, më mirë t'u jepet një investim tamam. Në vitin 2019 ju kishit 4 milionë lekë investime, keni realizuar vetëm 0,2 milionë lekë. Megjithatë Ministria e Financave jep prapë 4 milionë të tjera për vitin 2020 dhe unë nuk e kuptoj pse nuk investon asgjë! Pse ia jep një institucioni kur nuk është efektiv për ta bërë investimin? Ju jeni ekspert i fushës së financës më shumë sesa i anës juridike dhe duhet të bëni një analizë financiare, se ndryshon kur t'i bën investimin. Me të drejtë Ministria e Financave jep, dhe kur jep 4 milionë, por realizon 0,2, pastaj jep prapë 4 milionë investime të tjera, se këta qenkan dorëlëshuar për mua, se nuk duhet të jepte fare, pastaj ti vjen këtu kërkon më shumë investime. Kjo është absurde. Unë mendoj se shifrat e Gjykatës Kushtetuese janë shumë të sakta dhe të drejta dhe janë me rritje. Ju thashë edhe një herë, nga 114,7 milionë lekë,

që është totali i shpenzimeve, ne japim për vitin 2020 161 milionë. Shikoni sa rritje e madhe është! Që këtu nuk ka nevojë të flasë fare Gjykata Kushtetuese.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Përmeti ka pyetje.

Andi Përmeti – Mirë se erdhët!

Kam një pyetje specifike. Duke qenë se jeni i vetmi organ kushtetues në botë që keni dy punonjëse për të njëjtin vend, a keni kërkuar rritje buxheti për të dhënë dy rroga për të njëjtin vend pune, për të pasur dy karrige, dy kompjuterë? Nëse po, sa është kjo kërkesë? Nëse jo, merrni guximin të bëni atë që presin shqiptarët nga ju dhe të dilni e të refuzoni këtë turp dhe këtë luftë politike të dy personave për të kapur drejtësinë. Pyetja ishte pak absurde, por kur flasim për buxhetin, duket sikur flasim për një normalitet, kur në fakt, jemi në një absurditet që edhe Albert Kamy do ta kishte zili. Keni ju përgjegjësinë për të thënë që si fillim është ky problem. Nëse jo dhe nëse pyetja ime është absurde, ju lutem përgjigjuni! A keni kërkuar buxhet shtesë apo jo?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Përmeti!

A keni përgjigje për zotin Përmeti?

Eugen Papandile – Kam një përgjigje edhe për zotin Fino.

Unë këtu kam ardhur për buxhetin dhe rëndësinë kryesore do t'ua jap përgjigjeve për buxhetin.

Andi Përmeti – E para e punës, pyetja ishte për buxhetin.

E dyta, thoni “i nderuar zoti Fino dhe Përmetit”, ju lutem të ruani një barazi për çështje etike, se unë ju drejtova me etikë!

Faleminderit!

Eugen Papandile – Të nderuar zotërinj deputetë!

Zoti Përmeti, buxheti kërkohet për të 9 anëtarët, për të gjitha vakancat dhe jo për 1, 2 ose 3 anëtarë, apo për çështje të veçanta. Besoj se kjo është e ezauruar. Për sa i përket pyetjes tjetër, në fakt, ftesa më ka ardhur për buxhetin e shtetit dhe për buxhetin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe për nevojat e kësaj gjykate, e cila të paktën sa kam qenë sekretar i Përgjithshëm, e shoh që mbetet opozitë gjithmonë jo për shkaqe politike, por të buxhetit. Pra, për sa i përket pyetjes së zotit Përmeti, besoj se iu përgjigjja.

Tani do t'i përgjigjem pyetjes së zotit Fino.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kam unë sugjerim, më vjen keq.

Investimet janë kryer 100% bashkë me 2-mujorin e fundit, që ju nuk e keni mbi tavolinë, por do t'jua dërgoj nesër ose pasnesër, po flas për atë 4 milionëshin modest, por që është bërë. Po që se ne nuk kemi dhe nuk meritojmë investime, dakord, por kjo ishte kërkesa ime dhe e Gjykatës Kushtetuese, që unë përfaqësoj si administrator, megjithatë mendoj se e kemi shumë të nevojshme. Unë harrova t'ju sillja foto të zyrave të plasaritura, por mbase në një moment tjetër. Ne jemi një godinë, por nuk kemi të njëjtin trajtim.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Ka pyetje kolegu Qefalia.

Bashkim Fino – Përpara se të bëjë pyetje zotëria, dua të saktësoj se nuk thashë se nuk meritoni investime, sepse çdo institucion ka të drejtën e vet të kërkojë investime, unë thashë vetëm dy shifra dhe pres me padurim që të më vërtetoni se i keni realizuar. Unë thashë që nga 4 milionë investime, që ju janë dhënë për vitin 2019, në 10-mujorin faktik, se edhe dy muaj mbyllet viti, keni realizuar 0,2 milionë, pra keni realizuar shumë pak, që do të thotë se nuk ke pasur mundësi ta bësh investimin që të është dhënë dhe meqë nuk ke pasur mundësi, ne prapë të planifikojmë 4 milionë të tjera për vitin 2020. Ju më thoni që e keni realizuar 100%, por ky 100% është me dokumente, nuk është se unë flas i papërditësuar. Më vjen mirë nëse e ke realizuar investimin dhe më vjen mirë që Ministria e Financave të ka dhënë edhe 4 milionë të tjera shtesë për 2020-ën! Nuk thashë që nuk meritoni investime, por mbi bazën e analizës, kur bën një investim dhe kërkon, bravo të qoftë, por kur ta japin shumën dhe ti nuk bën asgjë, jo juve personalisht, por institucioni, atëherë pse duhet të të japim prapë para për investim? Këto janë fonde që digjen, nuk trashëgohen nga viti në vit. Po flas si ekonomist.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Xhemal Qefalia – Zoti kryetar, nuk e kisha për pyetje, por për këtë që sapo citoi zoti Fino, sepse si për institucionin e parë, si në diskutimin për buxhetin për Prokurorinë, ashtu dhe këtu, nuk ka një përditësim të shifrave. Edhe aty u tha që nuk ka realizim, ndërkohë që u kundërshtua nga përfaqësuesi i Prokurorisë se ka realizim. Kështu që do të jetë me shumë interes, e kam për Ministrinë e Financave, që t'i përditësojë shifrat dhe t'i vihet në dispozicion relatorit që të jemi korrekt. Edhe këtu konkretisht sapo e hodhi poshtë. Është 100% realizimi, e tha tani sekretari.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Qefalia!

Bashkim Fino – Këta duan të bëhen të gjithë ekspertë të fushën e financës, unë nuk bëhem dot ekspert në fushën e sigurisë, ku është zoti Qefalia dhe më vjen keq kur futesh në pozicionin tim, sepse jam i zoti ta mbroj dinjitetin tim. Edhe një herë, që të kuptohemi me

kolegët, se duket sikur po mbrojmë Ministrinë e Financave, këtu janë evidencat e fundit të tetorit të vitit 2019 nga thesari, i cili është hallka e fundit që lëshon paratë.

Këtu janë planifikimet e viteve të buxhetit, është realizimi i 2019-ës dhe projektbuxheti për vitin 2020. Sekretari i Përgjithshëm nuk tha që nuk është 0,2...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prit, se unë e kuptoj! A mund të vazhdoj?

Ulsi Manja – Ju lutem, pak qetësi, se shifrat janë kokëfortë dhe aty janë, nuk lëvizin, sepse janë rakorduar!

Bashkim Fino - Sekretari i Përgjithshëm, duke pasur parasysh që kemi hyrë në muajin e 11...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, por është çështje tjetër ajo, unë e bëj vërejtën mbi bazën e kësaj, se nga 4 milionë në 0,2 nuk mund...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se unë nuk jam aspak i vonuar për një gjë që e di shumë mirë! Nuk mund të realizosh 4 milionë investime për 2 muaj, kurrën e kurrës. Edhe ti kur ke qenë nuk i ke realizuar dot për 2 muaj. E gjithë situata e këtyre letrave është shumë e saktë, dhe duhet ta kuptojmë drejt atë që kërkoj.

Pse e them këtë? Këto fonde zerohen me 31 dhjetor, domethënë ti mund të kërkosh para për investime, por është gjynah të të ikin se këto fonde nuk transferohen për 2020-en, pra ti i djeg. Mund t'i kishte marrë një institucion tjetër, i cili mund ta bënte këtë investim. Ky është thelbi i diskutimit tim, prandaj lëre zoti Qefalia, se i kam letrat në rregull unë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Kam një pyetje për ju, zoti Papandile.

Në prezantimin e projektbuxhetit që bëtë, në kërkesën që i parashtruat komisionit për të plotësuar disa nga kërkesat tuaja për investime, është edhe numri i madh i çështjeve që e presin Gjykatën Kushtetuese. Sa është ky numër i kërkesave të depozituara në Gjykatën Kushtetuese, deri ditën që flasim?

Eugen Papandile – Nuk kam një shifër tamam, por është diku te 110, por të mos harrojmë që në momentin që Gjykata e Lartë do të nisë funksionimin, ajo shifër mund të shkojë edhe 1010, sepse lidhet gjithmonë me funksionalitetin e Gjykatës së Lartë. Ankimet e Gjykatës së Lartë vijnë drejtpërdrejt dhe, duke qenë se legjislatori ka parashikuar një 4-mujorësh për ankimin nga Gjykata e Lartë te Gjykata Kushtetuese, pra shumë më pak se e ka pasur 2 vjet.

Nga eksperiencia e vendeve të tjera me ndryshimet e bëra, duke futur edhe ankimin individual, do të ketë një fluks të madh kërkesash dhe për këtë jam i bindur.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Papandile!

A ka gjë tjetër nga kolegët? Nuk ka.

Gjatë këtyre ditëve, deri në votimin në seancë plenare, besoj se do të rrimë në kontakt me Ministrinë e Financës dhe me zotin Fino.

Ju nevojat i parashtruat, ne i morëm si komision. Do të kemi një seancë për të parë se si do t'i akomodojmë të gjitha kërkesat e paraqitura nga institucionet që janë sot, por që do të jenë edhe nesër në dëgjuesë në Komisionin e Ligjeve.

Shumë faleminderit, zoti Papandile!

Punë të mbarë!

Vazhdojmë me institucionin e radhës, që është Shkolla e Magjistraturës.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen, zonja Ela Qokaj, kancelarja e Shkollës së Magjistraturës dhe zonja Alketa Havari, përgjegjëse e Sektorit të Financave.

(Diskutime pa mikrofon)

Ela Qokaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Sikurse jeni në dijeni të veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës gjatë vitit në vijim, ajo ka filluar aktivitetin e saj akademik me një kapacitet të shtuar të kandidatëve për magjistratë, që ndjekin programin e formimit fillestar, janë rreth 60 e ca kandidatë, të cilët po vlerësohen edhe nga organet përkatëse të KLGJ-së dhe KLP-së për vlerësimin e pasurisë dhe figurës. Sigurisht që një numër i rritur i kandidateve sjell dhe një veprimtari të shtuar akademike, që shoqërohet me një faturë të shtuar financiare, e cila në pjesën më të madhe të saj është marrë në konsideratë nga Ministria e Financës gjatë përgatitjes së dy fazave të përgatitjes së buxhetit. Gjej rastin ta falënderoj Ministrinë e Financës për vëmendjen e kushtuar dhe mbështetjen e vazhdueshme për të vlerësuar nevojat tona për buxhet! Janë marrë në konsideratë shpenzimet operative, kryesisht për mbulimin e bursave të kandidatëve për magjistrat dhe orëve mësimore në programin e formimit fillestar. Po ashtu është marrë në konsideratë edhe shtimi i organikës me një punonjës, që është pedagog i brendshëm, por nuk është shtuar fondi i pagës për këtë pozicion, pra duhet të shoqërohet paralelisht me një fond page shtesë prej 3 milionë e 700 mijë lekësh në zërin 600-601 “pagat dhe sigurimet shoqërore”.

Në vijim do të doja të ndalesha pak në projektet e investimeve që Shkolla e Magjistraturës planifikon për tri vitet e ardhshme, pra edhe për vitet 2021 dhe 2022. Sikurse e keni ndjekur Shkolla e Magjistraturës e ushtron veprimtarinë e saj prej shumë vitesh në një kat pranë Fakultetit të Gjeologji-Minierave, në rreth 700-800 metra katrorë, dhe gjithmonë ka

kërkuar sistemim dhe zgjerim të ambienteve të saj. Situata është vlerësuar në vitin 2015, duke u bërë pjesë e një projekti për ndërtimin e një godine të re, që më pas u kthye në prioritet jo vetëm e strategjisë së Shkollës së Magjistraturës, por objektiv i qeverisë shqiptare nëpërmjet parashikimit të këtij objekti në strategjinë sektoriale të Ministrisë së Drejtësisë. Më pas është mbështetur me një buxhet edhe nga KE-ja më për financimin e ndërtimit të kësaj godine. Ka filluar të hartohet projekti i zbatimit të ndërtimit të kësaj godine, ku Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka ndjekur kontratën për hartimin e projektit të zbatimit deri në 2019-ën dhe duhej të dorëzohej në muajin qershor të këtij viti. Për shkak të një VKM “Për programin e integruar të zhvillimit të polit të drejtësisë”, u pezullua puna për hartimin e projektit për shkak të shfuqizimit të VKM-së së mëparshme, e cila e vendoste shkollën në oborrin e Fakultetit të Inxhinieri-Minierave dhe me vendimin e ri ajo është transferuar përkohësisht në ambientet e godinës që ka ndërtuar Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ku do të jetë bashkë me KLGJ-në dhe KLP-në. I është dhënë një hapësirë, të mos themi e mjaftueshme, por e nevojshme për emergjencën e fillimit të këtij viti akademik. Por projekti për zbatimin dhe ndërtimin e godinës së re ka vazhduar dhe tani që flasim, studioja projektuese ka dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit këtë projekt, i cili mendohet të investohet për 3 vjetët në vijim, duke qenë se është me mbështetjen financiare të KE-së.

Për këtë arsye, në zërin “investime” në 3 vitet në vijim për Shkollën e Magjistraturës janë parashikuar 60 milionë lekë për çdo vit, që kanë ardhur nga negociatat e vazhdueshme me Ministrinë e Financave për të investuar në këtë projekt. Por kjo vlerë është e vogël. Për vitin 2020 me 20% të vlerës totale të pretendimit që kanë nxjerrë studiot projektuese për projektin e zbatimit të ndërtimit të godinës, duhen 106 milionë lekë. 60 milionë lekë të parashikuara në tavanin e investimeve në Ministrinë e Financave për vitin 2020, mbulojnë nevojën e shkollës për 10 milionë lekë, që i duhen për pajisjen e ambienteve të reja, klasave dhe sallave të leksioneve me logjistikën e nevojshme në ambientet ku është transferuar përkohësisht, dhe 50 milionë plus një shtesë prej 56 milionë lekësh do t’i kërkohej t’i kalohej Fondit Shqiptar të Zhvillimit, që është struktura e ngarkuar për të ndjekur zbatimin e kësaj kontrate për ndërtimin e godinës së re të Shkollës së Magjistraturës dhe të tjera që do të jenë pjesë e këtij poli.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Me sa kuptova buxheti është fillim e mbarim për godinën. Zoti Fino. Fjala është për ju.

Bashkim Fino – Me këto që dëgjuam nga Ministria e Financave është gjynah të diskutosh. Nga të gjitha institucionet që shoh këtu, Shkolla e Magjistraturës është më e kompletuara me buxhet për vitin 2020, rreth 600% në raport me përqindjet e viteve të kaluara.

Po marr shpenzimet korrente, totali i shpenzimeve ne vitin 2019 kishte 178,7 milionë lekë, në fakt, këtë 10-mujor ka realizuar 130, ne i planifikojmë 254 milionë lekë, pra një rritje super e madhe.

Mallra e shërbime, që i kanë merak këta, në vitin 2019 kanë qenë 72,7 milionë lekë, por kanë realizuar vetëm 14,6 milionë në 10 muaj, nuk e di se çfarë do të bëjnë me këto 72 milionë. Në fakt, ne u kemi planifikuar 43,3 milionë lekë për 2020-ën.

Marrim investimet, edhe këtu kam vërejtje, sepse në vitin 2019 ne kemi planifikuar 8 milionë lekë investime të reja, por ka realizuar 4,7 milionë lekë deri tani, ndërkohë që u planifikojmë 60 milionë lekë në këta 3 vjet për ndërtim. Ideja është që çfarë kanë kërkuar nga Ministria e Financave ua kemi dhënë të gjitha, plus një punonjës shtesë, nga 34 vetë bëhen 35 dhe këtu brenda e kanë fondin e pagës. Kot ankohen që nuk kanë fond page, madje po të bësh kontrollin e fundit të pagës për këtë vit dhe për këtë 10-mujor, i bie të jetë suficit, pra ka lekë më tepër që nuk i ka dhënë për fond page.

Zoti kryetar, me këto shifra që janë paraqitur këtu dhe me këto pak investime që ka bërë, edhe pse ne i kemi dhënë 8, por e ka lexuar 4,7, mendoj se ajo duhet të na falënderojë që ngremë dorën për këto shifra, se mund edhe t'i shkurtojmë e të themi pse t'u japim kaq shumë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Besoj se situata është e qartë. Neve na kërkohet që për buxhetin e Shkollës së Magjistraturës të bashkohemi me falënderimin për Ministrinë e Financave dhe nuk na ngelet gjë tjetër. Është e vërtetë që Shkolla e Magjistraturës për shkak të reformës në drejtësi ka ngarkesë nga shtimi i kapaciteteve në këtë shkollë, por gjithsesi besoj se kolegët janë dakord që ta kalojmë projektbuxhetin i vitit 2020 për Shkollën e Magjistraturës për ato shifra dhe zëra që është dakordësuar edhe me Ministrinë e Financave.

Besoj se jemi të qartë, zonja Qokaj!?

Ela Qokaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë doja të bëja vetëm një sqarim të vogël lidhur me çështjen e investimeve. Vlera prej 8 milionë lekësh, që është akorduar për Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019 është drejt realizimit final, sepse procedurat për transferim kanë qenë të përfshira edhe në institucionet e tjera dhe investimet do të vazhdojnë deri në fund të vitit 2019, kështu që nuk do të mbetemi pa i shfrytëzuar, sepse janë nevojë e shkollës. Kemi një kontratë me AKSH-in në proces, i cili do të realizohet brenda muajit nëntor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk varet vetëm nga ne, kontrata është lidhur dhe presim vetëm likuidimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Qokaj!

Ju uroj ditë të mbarë!

Ela Qokaj – Faleminderit!

Punë të mbarë!

Ulsi Manja – Po, zoti Alimadhi, për procedurë.

Adriatik Alimadhi – Në fakt, ne sapo kaluam këto institucione dhe shoh që Shkolla e Magjistraturës na ka sjellë një informacion më të detajuar, më të plotë, do të kërkoja që të gjitha këto institucione të na e sillnin që ne ta kishim informacionin më të plotë. Kështu siç e ka sjellë Shkolla e Magjistraturës është më e ngarkuar dhe jo e qartë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Në fakt, në materialin voluminoz që keni për projektbuxhetin e vitit 2020, por edhe në materialin që ka përgatitur kolegu Fino, janë adresuar siç duhet, ndërsa institucionet që kanë nevoja shtesë buxhetore kanë zgjedhur, një pjesë e tyre t'i sjellin me shkrim dhe pjesa tjetër t'i prezantojnë direkt në komision. Shkolla e Magjistraturës dhe një institucion tjetër, të cilin do të kemi mundësi në vazhdim e sipër ta dëgjojmë, e kanë sjellë me shkrim adresimin e nevojave të tyre buxhetore dhe besoj...

(Diskutime pa mikrofon)

Ne nuk i detyrojmë dot institucionet për mënyrën se si t'i sjellin. Ata që e shohin të nevojshme t'i sjellin me shkrim, i sjellin, ndërsa të tjerët jo, ky është diskrecioni i tyre.

Sekretaria e komisionit dhe këshilltarët sa u takon institucioneve që kemi sot në dëgjesë, ata që i kanë sjellë me shkrim nevojat e tyre buxhetore, t'i fotokopjojnë dhe t'u vihen përpara kolegëve deputetë.

A kemi institucione të tjera?

Kemi.

Në fakt, ne i kemi njoftuar institucionet për orarin që ata do të kenë në dispozicion, por meqë institucionet e para që ishin të pranishme ishin të kënaqura me buxhetin e vitit 2020 mbaruan pak më parë.

Zoti Fino, besoj se janë të mjaftueshme 10 minuta pushim deri sa të paraqiten institucionet e tjera me radhë?

Ndërkohë, ju lutem, vendosni kontaktet me institucionet që të jenë të pranishme në komision!

Rifillojmë mbledhjen e komisionit me dëgjesat për buxhetin. Në radhë për të na bërë prezantimin e projektbuxhetit të institucionit që drejton është Këshilli i Lartë Gjyqësor. Të pranishëm në komision janë zonja Naureda Llagami, kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor,

zoti Maksim Qoku, zëvendëskryetar dhe zonja Luljeta Laze, specialiste e buxhetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Zonja Llagami, mirë se keni ardhur, së bashku me kolegët që ju shoqërojnë!

Ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër të nevojave buxhetore që keni për vitin 2020! Sa nga këto nevoja janë akomoduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe çfarë i kërkon sot komisionit që t'ju mbështesë në projektbuxhetin e vitit 2020.

Naureda Llagami – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në radhë të parë ju falënderoj për ftesën dhe për këtë seancë buxhetore lidhur me projektbuxhetin e vitit 2020!

Në hartimin e kërkesave të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022, KLGJ-ja është bazuar në misionin, qëllimin, prioritetet, objektivat strategjike dhe standardet që synon të përmbushë nga ana e saj si organ qeverisës i gjithë sistemit gjyqësor. Kërkesën tonë e kemi mbështetur në ligjet për hartimin e buxhetit, konkretisht: ligji nr. 8379 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”; ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe dy udhëzimet përkatëse, udhëzimin nr. 7, të vitit 2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe udhëzimin nr. 8, të vitit 2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022”, si dhe në parimin e eficiencës, efektivitetit, ekonomikitetit dhe transparencës.

Në program kërkesat buxhetore të sistemit gjyqësor për vitin 2020 janë programuar në shumën 3,76 miliardë lekë, ndërsa tavani buxhetor i miratuar është në shumën 3,48 miliardë lekë, që është rreth 280 milionë lekë ose 8% më pak.

Kërkesat e KLGJ-së janë hartuar në dy programe buxhetore. Programi i parë ka të bëjë me planifikimin, menaxhimin dhe administrimin, që lidhet me buxhetin konkret të KLGJ-së dhe programi i dytë ka të bëjë me buxhetin gjyqësor, i cili është programi 3310. Lidhur me buxhetin e KLGJ-së dëshiroj t'ju theksoj që ky lloj programi planifikimi, menaxhimi dhe administrimi synon garantimin e funksionalitetit normal të aktivitetit të institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke forcuar në këtë mënyrë pavarësinë, efikasitetin, transparencën, me qëllim që gjyqësori të meritojë besimin e publikut.

Qëllimi i këtij programi është përmirësimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet vendimmarrjes së këshillit lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve që përbëjnë edhe paketën e reformës në drejtësi, si dhe sigurimin e burimeve njerëzore dhe të kapaciteteve financiare të nevojshme. Kërkesat buxhetore për këtë program, pra për programin

e KLGJ-së, do t'i ndaja në kërkesën buxhetore për shpenzime personeli, që u përkasin kodeve 600 dhe 601, e cila është bërë sipas legjislacionit në fuqi dhe është në vlerën 215 milionë lekë, e cila përfshin pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Kuptohet që ne jemi dakord me tavanin e miratuar.

Kërkesat buxhetore për shpenzime operative, që i përkasin kodit 602, janë në vlerën 60 milionë lekë. Programi i fondit është bërë duke u mbështetur në numrin e punonjësve të administratës së KLGJ-së dhe në nevojat e tyre për mirëfunksionimin normal të veprimtarisë së institucionit. Edhe sa i takon kësaj kërkesë jemi dakord me tavanin e miratuar.

Kërkesat buxhetore për investime në kodin 231 është në vlerën 100 milionë lekë. Programi i fondit është bërë duke u mbështetur në përvojën e këtij viti dhe nevojat e parashikuara për vitin 2020. Dëshiroj t'ju bëj me dije se KLGJ-ja është përballur gjatë këtij viti edhe me nevoja shtesë, të cilat janë me këtë bazë ligjore, VKM-ja nr. 234 e vitit 2019 "Për programin e integruar për zhvillimin e polit të drejtësisë" dhe VKM-ja nr. 673 e vitit 2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".

Pra, arsyet që ne kërkojmë shtesë është se plotësimi i infrastrukturës së nevojshme të teknologjisë së informacionit në godinën e re që ne do të shkojmë, pra te Poli i Drejtësisë, ku do të sistemohet KLGJ-ja, fillimisht do të kryheshin nga AKSH-i. Ne jemi vënë në dijeni nga AKSH-i me shkresën e nëntorit 2019, të cilët na kanë njoftuar se nuk do t'i plotësojnë më nevojat e infrastrukturës së teknologjisë dhe informacionit në zërat e dakordësuar më parë me KLGJ-në. Pikërisht, për të mundësuar funksionimin normal të veprimtarisë së KLGJ-së për vitin 2020 i jemi drejtuar Ministrisë së Financave me shkresën e tetorit 2019, duke i kërkuar një shtesë fondi në shpenzime kapitale në vlerën 28 milionë lekë, për të përballuar shpenzimet e domosdoshme që na lipsen për fillimin e aktivitetit në godinën e re. Konkretisht, sistemi i regjistrimit audio dhe video për mbledhjet plenare të KLGJ-së dhe gjeneratorët për energji të pandërprerë për godinën. Kjo vlerë, në fakt, rrit kërkesën buxhetore në investime në 100 milionë kundrejt tavanit të miratuar në 70 milionë.

Gjithashtu, për plotësimin e objektivave strategjikë KLGJ-ja ka paraqitur edhe 3 kërkesa të tjera strategjike.

E para, ka të bëjë me krijimin e një sistemi të ri elektronik të unifikuar për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, e cila është pjesë e objektivit nr. 3 të planit tonë strategjik. Në fakt, dëshiroj t'ju bëj me dije, që edhe gjatë raportimit tim në Kuvendin e Shqipërisë e kam ngritur problematikën e mungesës së një sistemi, i cili na lejon prodhimin e të dhënave të sakta në të gjithë sistemin tonë gjyqësor. Ky sistem i ri që ne kërkojmë të bëjmë synon:

- rritjen e efikasitetit;

- saktësimin e të dhënave;
- efektivitetin në menaxhimin e çështjeve, sipas standardeve ndërkombëtare.

Kemi bërë një vlerësim lidhur me sistemin e ri, ky vlerësim është bërë nga Euralius-i, i cili na asiston, nëpërmjet të cilit na ka rezultuar që kostot e para të këtij sistemi shkojnë në rreth 3,5 milionë euro ose 440 milionë lekë. Për vitin 2020 ne i kërkuam qeverisë një fond të mjaftueshëm për fillimin e këtij projekti, por kjo gjë, me aq sa kemi vënë re, nuk është parashikuar në tavanin e miratuar.

Gjithashtu, po sjell në vëmendje se gjatë vitit 2020 është e pritshme që të krijohet Qendra e Teknologjisë dhe Informacionit pranë KLGJ-së. Po sipas Euralius-it dhe USAID-it shpenzimet për krijimin e kësaj qendre informacioni, që është detyrim ligjor, shkojnë në rreth 13 milionë lekë. Këto fonde duhet të akordohen të plota për të mundësuar funksionimin e kësaj qendre dhe për këtë qëllim kërkojmë që fondet e nevojshme për qendrën që do të krijohet të alokohen në momentin e miratimit të VKM-së për krijimin dhe funksionimin e saj.

Një çështje tjetër lidhet me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Sjell në vëmendje që, sa i takon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vitin 2020 fondet buxhetore duhet të akordohen veçmas si pjesë shtesë në buxhetin e Gjykatës së Lartë, sikurse u veprua edhe për vitin 2019, nëpërmjet VKM-së me nr. 298, datë 10.05.2019 “Një shtesë fondi nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për sistemin e drejtësisë”. Këto ishin pak a shumë ato që kishin të bënin me buxhetin e KLGJ-së.

Tani do t’ju flas për buxhetin e gjyqësorit, që do të thotë buxheti i gjykatave. Programi i buxhetit gjyqësor synon ofrimin efikas të shërbimeve dhe funksionimin më të mirë të gjykatave nëpërmjet një mbështetjeje buxhetore të shërbimeve gjyqësore dhe përmirësimit të infrastrukturës, si dhe rritjen e parametrave të cilësisë dhe të performancës sipas standardeve të Bashkimit Europian. Cilat janë kërkesat buxhetore për programin buxheti i gjyqësorit?

Së pari, është kërkesa buxhetore për shpenzime personeli 600-601, e cila kap vlerën 2,68 miliardë lekë. Programi i fondit të pagave është bërë duke u mbështetur në numrin aktual 1368 dhe kërkesën për rritjen e numrit të punonjësve të administratës gjyqësore me 157 veta. Në fakt, në tavanin për vitin 2020 është miratuar një shtesë punonjësish prej 100 vetash. Akordimi i kësaj shtese pa diskutim që do të ndikojë pozitivisht në ofrimin efikas të shërbimeve dhe punë më të mirë të gjykatave të të tria niveleve. Vazhdimi në mënyrë strategjike i plotësimit të kërkesave për shtesën e numrit të punonjësve të administratës gjyqësore, do të ndikojë në arritjen e standardeve europiane. Ju sjell në vëmendje që raporti gjyqtar-administratë gjyqësore, sipas standardeve europiane, është 1 me 3, ndërsa në gjykatat shqiptare aktualisht është 1 me 2,3. Për të qenë efektiv në përdorimin e këtyre fondeve kemi pasur në konsideratë mungesën e

gjyqtarëve në sistem, 56 gjyqtarë nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve plus 30 gjyqtarë të tjerë të shkarkuar nga KPK-ja dhe që paguhen me 75% të pagës, si dhe kohën e nevojshme për plotësimin e vendeve vakante në sistem.

Për sa më sipër jemi të mendimit që fondi i akorduar është i mjaftueshëm për mbulimin e kësaj nevojë. Përlllogaritjet janë bazuar në numrin e plotë të gjyqtarëve, sipas strukturës organizative të gjykatave të të gjitha niveleve. Pra, jemi shumë dakord me tavanin e miratuar.

Kërkesa buxhetore lidhur me shpenzimet operative, që ka të bëjë me zërin 602, është 505 milionë lekë, bazuar në numrin e punonjësve të administratës gjyqësore dhe nevojat e tyre për mirëfunksionimin normal të veprimtarisë së gjykatave në tre nivele. Tavani i miratuar është 437 milionë lekë. Në miratimin e tavaneve nuk është marrë në konsideratë buxheti faktik i shpenzimeve për vitin 2019 në vlerën 444 milionë lekë. Buxheti i miratuar me ligjin për vitin 2019 në këto shpenzime është 421 milionë lekë. Për të mbuluar nevojat e gjykatave u rialokuan nga shpenzimet e personelit, kuptohet me miratimin e Ministrisë së Financave një fond shtesë në vlerën 22,3 milionë lekë, si rrjedhojë shpenzimet e pritshme për vitin 2019 janë rreth 444 milionë lekë.

Disa nga kërkesat më të rëndësishme janë: 25 milionë lekë, e cila ka të bëjë me mirëmbajtjen e programit elektronik ekzistues të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, *cic mici*, e cila ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Drejtësisë në pronësi të KLGJ-së. Këto fonde për mirëmbajtje deri tani i janë akorduar Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa ne kërkuam që këto fonde tashmë t'i kalojnë KLGJ-së; 25 milionë lekë për impakt financiar të delegimeve të magjistratëve të shkarkuar nga mungesa e magjistratëve nëpër gjykata, duke rritur ndjeshëm shpenzimin në zërin dieta dhe udhëtime; 9 milionë lekë efekt financiar në shpenzimet për ruajtjen e godinave të gjykatave në rrethe, si rrjedhojë e rritjes së pagës minimale në shkallë vendi, konkretisht vendimit nr. 809 i vitit 2018 i Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër kërkojmë rritjen e buxhetit në shpenzime operative me 60 milionë lekë. Gjithashtu, një kërkesë tjetër buxhetore që kemi parashtruar ka të bëjë me zërin “investime” 231-i, i cili është në vlerën 199 milionë lekë, aq sa është edhe tavani i miratuar në fazën e parë. Programi i fondit për investime është bërë duke u mbështetur në të dhënat e detajuara, standardet dhe kërkesat e gjykatave për nevojën e parashikuar për vitin 2020. Kërkesa për vitin 2020 ka qenë e kushtëzuar nga miratimi i hartës së re gjyqësore. Përfundimi i këtij procesi, pa diskutim do të përcaktojë qartë nevojat reale në infrastrukturën ndërtimore dhe elektronike. Tavani i miratuar është në vlerën 158 milionë, pakësuar me 41 milionë, duke e krahasuar me tavanin e miratuar në fazën e parë. Ky fond i miratuar për investime në gjykata realizon vetëm vijueshmërinë e plotësimit të nevojave për pajisje elektronike, si dhe pajisje të zyrave dhe të

sallave të gjyqeve. Nëpërmjet këtij fondi nuk mund të fillohet asnjë projekt i ri për ndërtim gjykatash. Sikurse dihet godina optimale e gjykatës përbën themelin ku materializohet plotësimi i standardeve të gjykimit, shërbimi i publikut, siguria e palëve e të tjera standarde të detyrueshme, sipas kërkesave të ligjit e të një modeli europian të gjykatave.

Disa nga gjykatat që ne i konsiderojmë si të domosdoshme për t'u ndërtuar janë Gjykata e Lartë, Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë, gjykata e Durrësit, Gjykata e Shkodrës, e Fierit e të tjera, që janë gjykatat më të mëdha në vend dhe që kanë një impakt të drejtpërdrejtë në shërbimin e publikut. Ky fond nuk mund të sigurojë mundësi edhe për plotësimin e krijimit të ambienteve miqësore për të miturit në konflikt, detyrim ky që vjen nga zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale, por edhe nga strategjia sektoriale e drejtësisë, si dhe nuk mund të plotësohen nevojat që paraqiten për investime dhe për pajisje sigurie në gjykata.

Sa më sipër kërkojmë që të na miratoni shtesat e mëposhtme: 60 milionë lekë në shpenzime operative të kërkuara për gjykatat, programi i buxhetit gjyqësor, për mirëfunksionimin e aktivitetit në gjykatat e tre niveleve; 40 milionë lekë në investime për gjykatat me qëllim fillimin e krijimit të ambienteve miqësore për të miturit në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale dhe plotësimin pjesor të nevojave për sigurimin e gjykatave; 100 milionë lekë në investime për fillimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, gjithashtu shtesën në programin e buxhetit gjyqësor si nevojë buxhetore për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, pasi vendimi i qeverisë për KED-në ishte vetëm për vitin 2019.

Kjo ishte shkurtimisht një përmbledhje lidhur me qëndrimin e KLGJ-së sa i takon buxhetit. Nëse ju do të keni pyetje pa diskutim jam me hapur së bashku me stafin për t'ju dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve dhe sqarime për të gjitha çështjet që ju mund të keni.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Llagami!

Zoti Fino, fjala për ju.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Ngela shumë i befasuar nga ekspozoja shkatërruese e kryetares së KLGJ-së, por, në fakt është projektbuxheti i parë për të, kështu që e prisja një performancë të tillë. Zonja na bëri një analizë të detajuar që do ta kishin zili mbase edhe shumë ekonomistë që kanë kohë që trajtojnë këto çështje.

Më lejoni t'ju them, meqë edhe vetë jam ekonomist, që në relacionin dhe projektbuxhetin që keni është në total, pra edhe projektbuxheti i KLGJ-së dhe ai i gjykatave. Pra, projektbuxheti është në tërësinë e tij, pavarësisht se kryetarja e ndau në dy pjesë. Nga kjo pikëpamje mendoj që qeveria e gjyqësorit, që janë këta, kërkon fonde buxheti për vitin që vjen se si do të trajtohet veprimtaria e tyre gjatë vitit 2020. Unë mendoj se qeveria e madhe që ka

miratuar projektbuxhetin që kemi këtu, ka pasur një marrëveshje dhe koordinim ndërmjet zyrës përkatëse dhe Ministrisë së Financave është treguar koherente, dorëlëshuar dhe korrekte në të gjitha shifrat që do t'ju them më poshtë. Këtë e kam thënë edhe gjatë diskutimit në parim të buxhetit, që buxheti është si puna e asaj dasmës që i fton të gjithë dhe mund të mos ftosh ndonjë, por dasmën e bën dhe je i gëzuar. Kur mbaron dasma, dikush thotë që mua nuk më ftuan, por dasma doli e bukur. Edhe buxheti sa herë të kërkosht asnjëherë nuk ka fund, gjithmonë do të kërkosht më shumë, por nuk mund të plotësohen të gjitha kërkesat e çdo institucioni. Në mënyrë të veçantë kërkesat e KLGJ-së, për fat të mirë, janë plotësuar tej mase, gjë që kryetarja e tha pak në fillim shkarazi në fillim, por duhet ta mbyllte me një falënderim shumë më të madh.

A e dini pse? Po ju them një shifër mjaft interesante, gjë që nuk e thashë për institucionet e tjera më parë, sepse ishin institucione më të vogla, por institucioni juaj është më i rëndësishmi sa i takon projektbuxhetit. Totali i shpenzimeve që ne parashikojmë të votojmë në parlamentin shqiptar do të jetë rreth 46,34% më shumë sesa ka qenë vitin e kaluar, pra afro 50% më shumë me përafërsi; totali i investimeve që ne u japim për vitin 2020 në raport me vitin 2019, jo me vitet e tjera, është 40,74% më shumë.

Më lejoni t'ju arsyetoj më tej. Arsyetimi i mëtejshëm është që shpenzimet koherente ose shpenzimi i totalit për vitin 2019 ka qenë 2 miliardë e 377,4 milionë lekë, ndërsa ne parashikojmë të votojmë, të gjithë ju e keni përpara, nga 2,3 në 3 miliardë e 479,2 milionë lekë. Pra, ka një rritje totalisht shumë të konsiderueshme, zoti kryetar, nga 2,3 në 3,4 rritet totali i shpenzimeve.

A doni të flasim për mallrat dhe shërbimet? Mallra dhe shërbimet në vitin 2019 kanë qenë 454,7 milionë lekë dhe në vitin 2020 do të jenë nga 454,7 në 490,2 milionë lekë. Pra, një rritje e konsiderueshme.

A doni të bëj një analizë? E kam me ju si drejtoreshë. Analiza që do të bëj unë është kjo: Zonjë, ju keni realizuar në fund të 10- muorit të vitit 2019 nga 454,7 milionë lekë, 314 milionë. Pra, keni mbi 100 e disa milionë lekë të tjerë gjendje lekësh për shërbimet dhe mallrat, që do të thotë se nuk e keni planifikuar saktë dhe drejt. Duhet t'i kishit harxhuar, keni lekë për të harxhuar, keni një mundësi financiare prej rreth 150 milionë lekësh. Nuk mund t'i harxhosh ti 150 milionë lekë të rinj për dy muajt e fundit nëntor –dhjetor për shpenzime, sepse shpenzimet janë të ndara sipas muajve njëjloj.

Unë po bëj analizë ekonomike, se kryetarja mund të mos më kuptojë, por ti më kupton më mirë. Në momentin që ti në faktikun e vitit 2019 në fund të tetorit ke realizuar vetëm 314,7

nga 454,7 që është në total atëherë ke edhe 150 të tjera. Prapë ne kemi ndër mend që t'ju japim, pra qeveria, por ne do ta miratojmë 472 milionë lekë më tepër në raport me 454.

Vazhdojmë tek investimet. Investimet në vitin 2019 kanë qenë 162 milionë lekë, ne parashikojmë të japim 228 milionë lekë. A doni t'ju them se si është ecuria e investimeve? Kjo është skandaloze dhe për këtë kërkoj një përgjigje nga drejtoresha e buxhetit. Investimet për vitin 2019 që janë 162 milionë, këta kanë realizuar deri tani 61,1 milionë. Pra, nga 162 milionë që ne i kemi dhënë në vitin 2019, këta kanë realizuar vetëm 61 ose 62. Po 100 milionë investime si do t'i realizojnë për dy muaj? Prap po të shikoj këtë shifër, unë jam kritik ndaj Ministrisë së Financave. Kur ke 162 dhe ke realizuar 161 brenda 10-mujorit dhe ke edhe 2 muaj dhe nuk mund të realizosh 100% edhe qindëshen tjetër, si mund të realizosh ti, si mund të japësh ti 228 milionë për vitin tjetër, sepse kjo tregon performancë të dobët, pra që këta nuk i realizojnë investimet.

Në të gjitha elementet që kryetarja i tha këtu me të drejtë, jam plotësisht dakord dhe kjo duhet të shënohet në relacionin tonë, duhet të rakordohet me Ministrinë e Drejtësisë sistemi i ICMIC-së, duhet patjetër që 25 milionëshi t'i kalojë KLGJ-së mungon, por duhet të kalojë, sepse është një fond mirëmbajtjeje i sistemit, siç thatë ju, të cilin unë jam absolutisht dakord ta shënoj në relacion, ose kur të vijë ministrja e Drejtësisë, do t'ia heqim asaj dhe ta kalojmë këtu dhe të bëhet veprimi. Të vetmen gjë që ne mund të rregullojmë në të gjithë këtë rezume është ky 25 milionëshi që është shumë i domosdoshëm dhe që duhet kaluar. Të gjitha të tjerat pastaj shpenzime operative që kërkon drejtoresha, siç tha kryetari, 60 milionë e lart, ose ndërtimin e gjykatave, ose 40 milionë investime në gjykata, ose 100 milionë investime elektronike e të tjera, natyrisht janë kërkesa që asnjëherë nuk mbarojnë për gjyqësorin. Unë jam plotësisht dakord që ata të merren në konsideratë edhe nga fondi rezervë nëse ka. Jam dakord edhe me konceptin tuaj, që KED-ja ka një fond të veçantë për fondin rezervë edhe që nuk ngatërrohet me këtë, por që është pjesë e juaja që është në buxhet dhe do të kalojë si pjesë e juaja për aq kohë sa do të funksionojë KED-ja, sepse kam përshtypjen. Unë mendoj se këta duhet të na falënderojnë se i kanë me tepriçë edhe totalin e shpenzimeve, edhe shpenzimet e pagave dhe sigurimet shoqërore, edhe mallrat dhe shërbimet edhe investimet. Po të krahasosh me 10-mujori me vitet 2019-2020 janë goxha lekë, janë 46,7% më shumë shpenzime që do të marrin duke ngritur dorën ne dhe janë 40,75% më shumë investime që do të marrin vitin tjetër më shumë se janë në këto momente. Me këto shifra unë mendoj se edhe kryetarja e tha pak më parë që është e kënaqur, duke kaluar edhe 25 milionëshi që duhet ta vëmë patjetër nga sistemi i Ministrisë së Drejtësisë. Këto problemet e tjera unë mendoj se mund t'i zgjidhim brenda për brenda.

Nuk e di, kryetar, por kjo çështja e ndërtimit të gjykatave është një çështje që duhet të trajtohet hap pas hapi dhe duhet të kemi një plan më të detajuar. Ka një lidhje në mes financës dhe procesit si do të bëhet riorganizimi i gjykatave. Ne vërtet kemi ndër mend të bëjmë një riorganizim të gjykatave, por kemi edhe shumë gjykata të tjera.

Për shembull, unë jam deputet në Lushnjë, dhe i bie që gjykata e Lushnjës të jetë bosh, nëse ju keni ndër mend ta hiqni prej andej, i bie që ajo të vijë të punojë në funksione parti-time, dy-tri ditë në muaj. Mirëpo është bërë investim i madh atje, është godinë gjigante në mes të qytetit dhe në përgjithësi gjykatat janë shumë të mira në qytete kryesore, kështu që duhet ta shikojmë edhe në këtë prizëm. Unë mendoj se nuk duhet t'i trajtojmë çështjet që ju thatë si prioritete, që insistuat t'i trajtojmë në këtë projektbuxhet, por t'i trajtojmë gjatë viteve të tjera. Pra, unë mendoj dhe do t'ju lutesha që ta ngrinit dorën për këto shifra shumë dorëlëshuar që ka qeveria dhe Ministria e Financës për sistemin e gjyqësorit, për qeverinë e gjyqësorit, që e meriton, sepse është një sistem në vete dhe duhet t'i ketë këto fonde duke shtuar 25 milionëshin që t'ia marrim Ministrisë së Drejtësisë dhe t'ia kalojmë fondit të KLGJ-së. Besoj se edhe unë nuk do të diskutoj më ndonjëherë tjetër po të jem ndonjëherë relator në një projektbuxhet kaq të mirë për KLGJ-në.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Në fakt, ju e dini që unë për projektbuxhetin, për sa kohë jam deputet, pikë reference kam relativimin e zotit Fino, sepse në malin me shifra që ka projektbuxheti që ka ardhur në Kuvend, nuk orientohesh, por kam fatin që e kam zotin Fino relator.

Unë kam një pyetje për zonjën Llagami, që të jem i qartë edhe vetë. Më vjen mirë që qeveria i ka marrë në konsideratë dhe i ka akomoduar si duhet nevojat e Këshillit të Lartë Gjyqësor, por duke bërë një paralelizëm ju jeni qeveria e gjyqësorit, pra si qeveri e gjyqësorit keni marrë një buxhet për vitin 2020 në total. Unë dua ta di që Gjykata e Lartë është brenda buxhetit të gjyqësorit, apo është buxhet më vete?

Nureda Llagami – Është brenda gjyqësorit.

Ulsi Manja–Atëherë, ju keni akomodimin e buxhetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si qeveri gjyqësorit dhe akomodimin e buxhetit gjyqësor për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Pra, keni dy degë, këtë buxhet që keni marrë nga qeveria e ndani disa për vete dhe pjesën tjetër për sistemin.

Nureda Llagami- E sqaruam këtë gjë që kemi dy programe buxheti, i pari është i KLGJ-së dhe i dyti është i gjyqësorit.

Ulsi Manja- Projektbuxheti i vitit 2020, në vlerësimin tim, dhe mesa relaton zoti Fino, është buxheti i parë ku ju do ta keni unik të plotë buxhetin, pra do të jetë Këshilli i Lartë

Gjyqësor, sepse në buxhetin e vitit 2019 kemi rakorduar për buxhetin gjyqësor me zyrën e administrimit të buxhetit gjyqësor, ndërsa sivjet KLGJ-ja merr përgjegjësinë e hartimit dhe të konsolidimit të buxhetit edhe për veten e vet, edhe për sistemin gjyqësor. Jam plotësisht dakord për 25 milionëshin që do të duhet t'i merret Ministrisë së Drejtësisë duke qenë se ligji sistemin e lë në përgjegjësinë e KLGJ-së, ndërsa për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe për KLD-në nuk di a do të vazhdohet të operohet me vendim të Këshillit të Ministrave për të akorduar buxhet nga fondi rezervë për aq kohë sa do ta ushtrojë veprimtarinë KED-ja, i cili nuk është organ i përkohshëm, është organ kushtetues dhe do të vazhdojë funksionimin. Nuk besoj se buxheti i KED-së ka pasur nevoja aq të mëdha. Ato që kishte iu akomoduan vjet me VKM dhe nuk besoj se ka nevojë që të ndalemi të buxheti për këtë gjë.

A janë dakord kolegët?

Bashkim Fino- Edhe numrin ia rritët, me rreth 100 veta, pra nga 1493 veta në vitin 2020, do të kenë 1593. Nuk e thashë këtë element se ky është element i rëndësishëm që në këtë pikë do të venë 1593 në sistemin gjyqësor. Në këtë pikë që ta dini ju, kryetare, ne jemi shumë dorështrënguar. Sot në Shqipëri, sipas kësaj listës këtu janë 82377 punonjës, duke filluar nga presidenti te punonjësi më i thjeshtë. Ky është numri dhe në këtë numër ne kemi shtuar edhe 100 veta në qeverinë tuaj të gjyqësorit.

Pra, buxheti këtë radhë është në kompleksitet të të dyja këtyre, të KLGJ-së ose të zyrës së mëparshme, të cilat duhet të ushtrojnë një program të veçantë në total, për mendimin tim si ekonomist, sepse ky është projektbuxheti i KLGJ-së, nuk mundet dot që këta të kenë dy-tre sisteme në kompjuter. Duhet të themi këto janë lek për atë ose për këtë.

Shpenzimet operative janë një për ju, dhe këtu futen të gjitha me KLGJ, KED e të tjera, të gjitha janë shpenzime që do t'i kollandrisësh ti. Kjo do të thotë që është buxheti i parë dhe duhet ta themi me forcë për hir të së vërtetës, jo për të bërë politikë, është buxheti i parë pas krijimit të institucionit të ri të KLGJ-së dhe KLP-së që ne, se ky ishte dhe vitin e kaluar, por sa kishte filluar, kërkuan numrin e punonjësve strukturën e të tjera. Është buxheti i parë që është me këmbë në tokë dhe e kemi me një rritje të konsiderueshme. Nëse ky buxhet do të na ekzekutohet në funksione të shifrave me sukses vitin që vjen, atëherë kjo është gjë e mirë për ta për të kërkuar më shumë për vitin 2021. Në të kundërt, duhet të bëjmë një analizë të 10-mujorit.

Unë kam shumë vërejtje, por po e lë me kaq, meqenëse sa është krijuar si institucion i ri dhe mund të mos ketë ndonjë përgjegjësi pse nuk e ka krijuar ai shpenzimin, pse nuk e ka krijuar ai investimin dhe kanë mbetur këto më pak. Po e lë me kaq, por vitin që vjen nuk ka asnjë justifikim, sepse është një KLGJ e madhe tani. Këta merren me çështjet e tyre sipas ligjit,

ka një drejtori të buxhetit të madh që duhet të bëjë analizë në çdo dy-tre muaj dhe me Ministrinë e Financave duhet të rakordojë që lekët nuk mungojnë, janë, por ato të ezaurohen me intensitetin e duhur për KLGJ-në dhe jo për gjëra të tjera. Këto shifra ne duhet t'i miratojmë si edhe kalimin e 25 milionëve nga Ministria e Drejtësisë te kjo dhe e lëmë me kaq.

Ulsi Manja- A jeni dakord me sugjerimet e kolegut Fino për buxhetin e KLGJ-së?

Adriatik Alimadhi – Këto mbetjet që kanë mbetur nga këto institucione, zoti Fino t'ia paraqesë Ministrisë Financave për t'i shtuar diku në një strukturë të vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit

Ulsi Manja - Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Gabim nga Ministria e Financave në momentet e gjata të punës që është harruar pa kaluar nga Ministria e Drejtësisë te KLGJ-ja.

Ulsi Manja - A jeni dakord?

Dakord.

Atëherë edhe me sugjerimin e zotit Fino edhedakordësinë e Ministrisë së Financave kalojmë buxhetin e KLGJ-së.

Faleminderit!

Vazhdojmë me institucionin tjetër në radhë, që është KLP-ja.

Sot kemi prezent zotin Gent Ibrahimi, kryetar i KLP-së, dhe zonjën Ilirjana Nano , sekretare e Përgjithshme.

Zoti Ibrahimi, keni fjalën.

Një prezantim të shkurtër të nevojave buxhetore për vitin 2020.

Gent Ibrahimi – Faleminderit!

Në lidhje me kërkesat buxhetore të KLP-së për vitin e ardhshëm 2020, e vërteta është se ka një dallim midis tavaneve buxhetore të dhëna nga Ministria e Financave dhe kërkesat e Këshillit. Totali i diferencës midis tavanit buxhetor dhe kërkesës së Këshillit është 214 milionë lekë. Më lejoni t'ju shpjegoj se për çfarë është fjala.

Një pjesë e shtesave që propozohen për vitin 2020 lidhen me nevojat tona për shtim të numrit të punonjësve të administratës. Konkretisht në organikën e propozuar prej nesh kërkohet një shtesë prej 4 sekretarësh, ideja është që këta sekretarë të funksionojnë secili pranë njërit prej komisioneve të Këshillit dhe pranë këshilltarit të Etikës. Ju e dini që KLP-ja funksionon i organizuar në rreth 4 komisione që janë procesuesit e lëndës së parë të Këshillit

është Komisioni i Karrierës, i Disiplinës, i Vlerësimit të Performancës së Prokurorëve dhe i Buxhetit dhe Administratës. Këto komisione funksionojnë si organe të mirëfillta kolegjiale me axhenda, me mbledhje me regjistrim të diskutimeve gjatë këtyre mbledhjeve. Gjithçka që vjen në mbledhjen plenare të Këshillit procesohet paraprakisht nga komisionet, kështu që edhe në vijim, me logjikën e ligjit, këto 4 komisione duhet të mundësojnë që ta kryejnë veprimtarinë e tyre në mënyrë optimale, prandaj ne kërkojmë që ata të asistohen me sekretarë, të cilët do të jenë përgjegjës për dokumentimin e mbledhjeve të komisioneve që mbledhja plenare të funksionojë siç duhet.

Një shtesë tjetër që lidhet me propozimin tonë për shtesa në organika ka të bëjë me numrin e shoferëve që funksionojnë pranë KLP-së. Ne në organikën aktuale, në një përpjekje për të qenë sa më të kursyer, kemi vetëm 7 shoferë, por gjatë këtij viti që ne kemi funksionuar si organ, kemi pasur rastin që të diskutojmë çështje që kanë të bëjnë me statusin e anëtarëve të KLP-së, i cili, siç e dini, është statusi i anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe në këto kushte gjitha paketa e trajtimit që u rezervohet anëtarëve të Gjykatës së Lartë, përfshirë edhe shërbimin e transportit, siç parashikohet edhe nga ligji për transportin e funksionarëve publikë, do të duhet të vihet në dispozicion edhe të anëtarëve të KLP-së, ndërkohë që kjo është bërë edhe nga KLGJ-ja, kështu që për analogji duhet bërë edhe për KLP-në. Pra, ne kërkojmë një shtesë prej 6 shoferësh.

Një tjetër shtesë ka të bëjë me specialist të IT-së, aktualisht në organikë kemi vetëm një, volumni i punës në institucion është i tillë që përcakton nevojën edhe për një tjetër.

Nga fillimi i vitit që vjen mendojmë se do të lëvizim te godina e re, e cila vërtet është shumë më e gjerë në krahasim me ku jemi sot, në këto kushte nevoja për shërbimin e pastrimit rritet, kështu që kemi kërkuar shtimin e punonjësve të pastrimit me 3 syresh.

Të gjitha këto përcaktojnë nevojën për një shtesë në fondin e parashikuar në artikullin 600, një shtesë prej 11 milionë e 508 mijë lekësh, dhe në artikullin 601 një shtesë prej 1 milion e 922 mijë lekësh.

Gjithashtu, një zë tjetër që është parashikuar në projektbuxhetin e paraqitur nga Këshilli është detyrim i prapambetur për tre anëtarë të Këshillit, e kam fjalën për faktin që tre nga anëtarët aktualë të KLP-së janë emëruar si të tillë në shkurt të vitit 2018 dhe kanë qenë të papunë deri në dhjetor të vitit 2018, kur Këshilli filloi nga puna, duke qenë se ata kryenin detyrën e avokatit, kanë qenë në pamundësi për ta ushtruar funksionin gjatë këtyre 10 muajve, kështu që në raport me këta tre kolegë kemi një detyrim të prapambetur në formën e pagave të munguara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kanë bërë avokatinë, sepse i ndalon ligji. Nga momenti që janë emëruar nga Kuvendi, kanë pushuar së punuari, sepse licencat janë të kontrollueshme, kështu që ne kërkojmë që ky detyrim i prapambetur të bëhet pjesë e këtij buxheti.

Në total, kërkesa për shtim të fondit të pagës për vitin 2020 është 17 milionë e 275 mijë lekë, ndërsa shtesa për artikullin 601-601 është 2 milionë e 544 mijë lekë.

Për hartimin e këtyre kërkesave jemi mbështetur në performancën e shpenzimeve operative gjatë vitit 2019, si dhe të përparësive që ka institucioni për zëra të veçantë.

Siç shihet edhe nga pasqyra përkatëse, kërkesa jonë për këtë artikull është më e lartë se limiti. Kjo vjen si rezultat i nevojës për shpenzimet që ka institucioni, veçanërisht në zërat “shpenzime qiramarrje automjesh, dieta, shpenzime pritje-përcjellje, shpenzime të ruajtjes dhe sigurisë së institucionit, shpenzime transporti”. Shtesa e fondit për artikullin 602 është 5 milionë e 917 mijë lekë.

Për sa i përket fondit të investimeve, fondi i alokuar me tavanet buxhetore nuk është në përputhje me nevojat e institucionit. Kërkesat i kemi paraqitur të detajuara në pasqyrën “Investimet publike” me financim të brendshëm, për të cilat nevojitet një shtesë prej 5 milionë e 15 mijë lekësh për blerjen e 2 automjeteve.

Kërkesat buxhetore të institucionit për vitet 2020-2021 dhe 2022 janë si më poshtë:

Për vitin 2020 (po jua kursej shifrat, sepse ju i keni në relacionin që ju kemi paraqitur), është nevoja për një fond shtesë që ka të bëjë me sigurimin e pajisjeve të regjistrimit të mbledhjeve të këshillit. Në periudhën e diskutimit të shpenzimeve që do të diktoheshin nga lëvizja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë te godinat e reja, me urdhër të Kryeministrit është ngritur një grup pune për rolin e drejtësisë. Ky grup pune do të duhet të përcaktonte shpenzimet që do të kërkonte transferimi i këshillit në godinën e re dhe burimin e shpenzimeve dhe në atë grup pune është përcaktuar që mobilimi i godinës dhe nevojat për teknologjinë e informacionit të mbuloheshin nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Me sa duket kjo gjë nuk është e mundur, kështu që po bëhemi gati të lëvizim në një godinë të re, nuk ekziston një sistem i regjistrimit të mbledhjeve të këshillit. Ju e dini që për çdo organ kolegjal regjistrimi i mbledhjeve është jetik. Në praktikën tonë të punës, vetëm 1 orë pasi mbyllim mbledhjen, hedhim në faqen tonë të internetit gjithçka që është thënë atje, kështu që në këto kushte, ne kemi një preventiv, i cili është rakorduar edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe ky preventiv tregon se kemi nevojë për një investim shtesë prej 15 milionë lekësh për të mundësuar sistemin e regjistrimit të mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Jam i qartë se te buxheti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë flitet vetëm për të, ndryshe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, që kishte edhe buxhetin e administrimit të sistemit gjyqësor, sepse prokuroria e juridiksionit ka buxhetin e vetë.

Fjala është për zotin Fino, si relator.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe kryetarit të KLP-së!

Në fakt, ngela pak i zhgënjyer, me thënë të drejtën si ekonomist, jo si jurist, me shifrat që njoh dhe kam këtu, por edhe për shkak se para disa kohësh kam qenë relator për strukturat e dy institucioneve shumë të rëndësishme, KLGJ dhe KLP, dhe kemi biseduar shumë herë për ta bërë efektive sidomos strukturën e KLP-së.

Nuk po them atë fjalinë zhargon që dikur punën tuaj e bënte një drejtori me 10 vetë, dhe sot që kemi një institucion të maturuar saktë dhe drejt, e bëjnë 65 vetë. Kemi diskutuar disa herë për strukturën dhe në fund kemi ngelur të kënaqur të gjitha palët, sidomos ju, që e bëni këtë punë, por meqenëse bëtë disa kërkesa, që për mua janë absurde, ose ju mund të bëni kërkesa, por varet se sa do të jenë në gjendje deputetët dhe komisioni për t'i marrë në konsideratë, ku kërkuat 4 sekretarë shtesë për të qenë pranë 4 komisioneve, rritjen e numrit të shoferëve, rritjen e punonjësve për informacion, pastaj të vijmë tek ajo që unë kërkoj ndjesë që ndërhyra padrejtësisht kur flisnit për 3 anëtarë, të cilët nga shkurti i vitit 2018 deri në dhjetor kërkonin pagën e munguar.

Zoti Ibrahim, më lejoni t'ju them se në strukturën e miratuar me dakordësinë tuaj dhe tonën, të sforcuar në atë kohë, ju keni në organikë 7 shoferë, 1 ju dhe 6 të tjerë. Është një institucion prej 65 vetash, 7 nga të cilët i ka shoferë, që për mua është më se e mjaftueshme, më duket absurde të vini sot dhe të kërkonit të rrisni sërish numrin e tyre në këtë projektbuxhet. Më falni që e banalizoj, por jam i detyruar.

Kërkoni shtesë për departamentet që keni atje, më lejoni t'ju them se keni drejtor departamenti, drejtor të njësisë së re, 2 drejtorë dhe 17 këshilltarë që bëjnë 19 veta, 4 përgjegjës sektori dhe 10 specialistë dhe të kërkonit sërish shtesë, mua më duket absurde në konceptin tim personal.

Po hyj te shifrat konkrete, ju duhet të falënderoni Ministrinë e Financave në rakordimin që ka bërë, por duhet të na kërkonit edhe neve, si deputetë, që t'i pranonim shifrat që ka sjellë kjo ministri, se ne mund të bëjmë edhe ndryshime duke mos rënë dakord me to.

Më lejoni të them shifrat: totali i shpenzimeve për vitin 2019 për institucionin tuaj ka qenë 88 milionë lekë. Ajo që parashikon ministria dhe qeveria shqiptare për KLP-në dhe që na

thotë neve të ngremë dorën për miratim, është nga 88 milionë në 152.3 milionë lekë, pra është dyfishi. Çfarë po na thoni tani, që as këtë dyfishim nuk e doni? Atëherë, le ta ulim!

Vazhdojmë më tej. Doni mallra dhe shërbime? Në vitin 2019 institucioni juaj ka pasur 20 milionë lekë mallra dhe shërbime, ndërkohë që në projektbuxhetin e vitit 2020 parashikojmë 22.1 milionë, pra gjithmonë në rritje rreth 2.1 milionë më tepër. Kjo më duket shumë e konsiderueshme duke mos bërë analizën dhe këtu e kam me ekonomistët që ke në krah, mallrat dhe shërbimet e planifikuara për vitin 2019, për shkak se institucioni është krijuar pak më vonë, kanë qenë 20 milionë, nga të cilat janë realizuar vetëm 2.2 milionë, pra ngelen rreth 18 milionë të pashpenzuara. Kjo do të thotë që keni mundësi për t'i shfrytëzuar dhe nuk do të mundeni t'i shfrytëzoni vetëm për këta dy muaj të mbetur të këtij viti.

Vijmë tek investimet: në vitin 2019 keni pasur zero investime. Në vitin 2020 ministria dhe qeveria ju ka parashikuar 17 milionë lekë investime, pavarësisht se ju do të shkoni në një godinë të re, që do të thotë se investimin që thatë, 15 milionë, ja ku e keni, te ky 17 milionësh që mund ta realizoni për kalimin që do të bëni te godina tjetër.

Në fund fare, zoti kryetar, po të shikosh rritjen në përqindje kundrejt vitit të kaluar, KLP-ja si institucion në totalin e shpenzimeve ka 73.1% më tepër fonde seç kishte në vitin 2019, e ndarë kjo për shpenzime korrente 53.8% më shumë dhe për investime 66.5% më shumë.

Më lejoni t'ju them, zoti kryetar, juve dhe kolegëve, kur një institucion merr 73.1% më shumë fonde seç merr nga viti 2019, si mund të vish të kërkosh akoma më tepër, ndërkohë që është institucion i konsoliduar që ka filluar nga puna, dhe siç thatë edhe ju, është thjesht si KLP, pa llogaritur fondet e Prokurorisë së Përgjithshme, të SPAK-ut dhe të gjithave me radhë, që janë pjesë e atyre që i kaluam dhe i miratuam. Mendoj se kryetari i KLP-së duhet të na falënderojë për shifrat që janë këtu dhe të na lutet, jo në sensin negativ, por në sensin pozitiv, personalisht do t'ju lutesha edhe juve, si deputetë, që t'i miratojmë këto shifra, se janë shifra inkurajuese për buxhetin e KLP-së për vitin e ardhshëm. Nuk është inkurajues numri i punonjësve, se nuk mund të diskutojmë sërish dhe ta ndryshojmë strukturën duke shtuar disa shoferë, sekretarë e të tjerë. Këtë mundësi e kishim dhe e bëmë dy herë gjatë vitit të kaluar, në mos gaboj, dhe luftuam me të gjitha forcat të realizonim dëshirat e institucionit, jo tuajat personale. Edhe nëse do të donim ta ndryshonim numrin e punonjësve vit pas viti, këtë nuk e bëjmë dot, zoti Ibrahim, sepse kemi një tabelë të buxhetit që na thotë se numri i punonjësve në Republikën e Shqipërisë për vitin 2020 do të jetë 82 mijë e 377 vetë duke filluar nga Presidenti i Republikës deri te më i vogli. Këtë numër ne nuk mund ta ndryshojmë. Edhe në qoftë se për një moment do të kishim dëshirën t'i shtonim disa shoferë apo sekretarë, do të thotë se duhet t'i heqim nga një institucion tjetër që kjo shifër të ngelet po njësoj, sepse është

shifër e panegociueshme në kuadër të bashkëpunimit që ka Ministria e Financave me FMN-në dhe të gjitha instrumentet e tjera financiare.

Kështu që unë mendoj, kryetar, pavarësisht kërkesave të drejta që ka kryetari i KLP-së, se investimi që është vënë këtu, është bërë shumë mirë dhe ka mundësi që pjesa e fundit të realizohet nëpërmjet këtij investimi që është në projektbuxhetin e vitit 2020, ndërsa kërkesat e tjera për shoferë e sekretarë, mendoj të mos merren në konsideratë, sepse janë të parakohshme dhe duhet t'u lëmë mundësi vitin tjetër për të parë performancën e institucionit dhe për të rritur më pas numrin e punonjësve të sektorit ndihmës. Ky buxhet nuk e cenon fare këtë institucion, përkundrazi, i jep mundësinë që me këtë sistem dhe këtë buxhet aktiviteti të jetë i shkëlqyer. Kërkesat e tjera mund t'i shikojmë gjatë vitit të ardhshëm, por në këto momente më duket e tepërt që t'i rishikojmë.

Do t'ju kërkoja që këto shifra për KLP-në t'i miratojmë dhe t'i çojmë një relacion Komisionit të Ekonomisë, pavarësisht se janë rreth 73% më shumë se viti 2019.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Alimadhi ka një pyetje.

Adriatik Alimadhi – Meqë zoti Ibrahimimi e trajtoi çështjen dhe tha se të njëjtat të drejta ka një anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë me një anëtar të Gjykatës së Lartë Kushtetuese, do të doja të dija, në fakt, a kanë shoferë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese? Kjo pyetje në fakt, është për ju, zoti Fino.

Bashkim Fino - Në strukturë kanë. Kur kemi bërë strukturën, kemi rakorduar 6 plus 1. Është më se e mjaftueshme. Të mos harrojmë edhe një gjë tjetër, se është turp ta ulim nivelin e diskutimit të projektbuxhetit për numrin e shoferëve, për mua ka rëndësi, kolegë, të di që buxheti i shtetit t'i japë mundësinë institucionit të vazhdojë punën për të cilën është ngritur dhe a pengohet në veprimtarinë e tij në qoftë se nuk ka fonde për veprimtarinë për të cilën është ngritur me ligj. Në qoftë se do të arrijmë të diskutojmë gjëra të tilla, si duhet një sekretar, apo shofer, unë nuk diskutoj për to...

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Jo, nuk janë të drejta, e drejtë është që unë t'i jap mundësinë...

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Dakord, ti kështu e vlerëson, por kjo ishte përgjigjja ime.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Keni pyetje tjetër, zoti Alimadhi?

Adriatik Alimadhi – Kjo qeverisje e ka gjetur personin e duhur, relatorin për projektbuxhetin, zotëria është nga Gjykostra dhe më mirë se kaq, nuk ka ku të shkojë!

Nga momenti që një anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë i është hequr e drejta, a ka të drejtën të trajtohet me pagë? Po ose jo.

Gent Ibrahimi – Do të doja të jepja disa nuanca shtesë në përpjekje për të ndihmuar në vendimmarrjen tuaj.

Pa dyshim, zoti Fino, që Këshilli i Lartë i Prokurorisë është bashkautor i organikës dhe i buxhetit që kemi sot, nuk diskutohet, kështu që është e vërtetë ajo që thatë, që bashkë jemi ulur më shumë se një herë për të diskutuar, por të gjitha këto në atë kohë ishin vetëm teori dhe pas një viti në detyrën time si kryetar i këshillit, di më shumë seç dija në atë kohë. Di nevojat e vërteta të punës së këshillit, di procedurat e punës, di më mirë çka pritet nga ne e kështu me radhë.

Është e vërtetë që dikur çështjet e burimeve njerëzore në sistemin e prokurorisë menaxhoheshin nga një drejtor në Prokurorinë e Përgjithshme, por tani po flasim për një nivel krejt tjetër dhe këtë nivel nuk e them unë, por e ka përcaktuar Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ajo ka vendosur që mënyra se si menaxhohen burimet njerëzore në sistemin e prokurorisë është e një rëndësie themelore për shtetin e së drejtës në Shqipëri. Pra, mënyra se si merren vendimet për emërimin e një prokurori, për transferimin, për ngritjen në detyrë, për shkarkimin e një prokurori është themelore për shtetin e së drejtës dhe pas kësaj për gjithçka tjetër, se kjo është gjëja e parë dhe e fundit në llogaritë që bëjmë ne në ngritjen e institucioneve. Pra, kjo është themelore dhe këtë ngritje në rëndësi të këtij procesi të rëndësishëm, që është menaxhimi i burimeve njerëzore në sistemin e drejtësisë, nuk e kam bërë unë, e ka bërë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte, është e domosdoshme që buxheti t'i përgjigjet kësaj stature të re, të kësaj detyre të vjetër.

Sa i takon çështjes së shoferëve, jam dakord që nuk është gjë shumë e rëndësishme në pamje të parë, por ka të bëjë me statusin e këtyre njerëzve. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe ligji për shërbimin e transportit të funksionarëve publikë në Republikën e Shqipërisë parashikon që këta mbështeten me shërbimet e një drejtuesi mjeti. Një përpjekje më e hershme që ka bërë Kuvendi dhe qeveria për t'i privuar anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese nga shërbimi i transportit, është gjetur antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese e këtij vendi. Në këto kushte, jemi para domosdoshmërisë për ta ofruar këtë shërbim.

(Diskutim pa mikrofon)

Nuk ia vlen që ne të dy të futemi në diskutimin kushtetues kur Gjykata Kushtetuese e këtij vendi ka thënë: “Anëtarët e Gjykatës së Lartë do të duhet të përfitojnë nga shërbimi i transportit”. Kjo është fjala e fundit në këtë kapitull. Kështu që, kush jam unë që ta vë në diskutim këtë?

Sa i takon çështjes së numrave shtesë, është e vërtetë që jemi ulur e kemi diskutuar bashkë, por tashmë jemi pas një viti dhe ky vit ka shërbyer për shumë gjëra. Sa i takon nivelit të realizimit të buxhetit aktual, është e vërtetë që nuk është në lartësinë e duhur, kujtoj vetëm se buxheti i ishte alokuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë në qershor, jo në janar. Kujtoj edhe që profili ynë në regjistrin e prokurimeve publike është bërë aktiv nga fundi i korrikut, ndërkohë që edhe njerëzit kanë filluar të punësohen në këtë periudhë, është thjesht e pamundur që ritmi i realizimit të shpenzimeve të ishte siç është parashikuar.

Mungesa e ambienteve ka qenë një arsye tjetër pse nuk janë shpenzuar paratë. Nuk kemi paguar pagat, sepse fillimisht këshilli ka pasur vetëm anëtarët dhe kabinetin e kryetarit. Pastaj, dora-dorës janë shtuar edhe burimet njerëzore dhe kuptohet kanë filluar të paguhen më shumë nga zëri “Pagat”. Sot e kësaj dite që flasim kemi rreth 20% të personelit të papunësuar, të parekrutuar dhe arsyeja është shumë e thjeshtë, nuk kemi ku t’i fusim. Sot që flasim, njerëzit ndajnë 4 vetë një zyrë modeste. Kështu që kemi fondet, por nuk i shpenzojmë dot për këto arsye objektive.

Në këto kushte, do të thosha të shikoni mundësinë edhe për këto kërkesa shtesë. Jam shumë koshient për kufizimet buxhetore. Në fund të fundit, kjo është natyra e këtij diskutimi, ju jeni në mbrojtje, ne jemi në sulm, kështu që duhet të gjejmë një rrugë të mesme. Kjo është kryesorja.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Dua të shpjegoj që jemi në të njëjtën gjatësi vale për shifrat e vitit 2019 dhe për ato të vitit 2020. Unë e di që institucioni nuk ka filluar dhe nuk e ka shtrirë aktivitetin gjithë vitin 2019. Shifrat këtu janë për gjashtëmuorin e dytë, të cilën ne si qeveri e kemi planifikuar dhe e kemi dhënë. Për shkak të tyre, keni edhe një rritje të konsiderueshme (dyfish) për vitin që vjen, duke menduar që do të jeni me kohë dhe me numër të plotë të të gjithë personelit. Ky është ndryshimi që kemi bërë në këtë projektbuxhet.

Dikush mund të thotë: si ka mundësi që këtë vit u jepni 88 milionë dhe vitin tjetër u jepni 152 milionë? Ua japim sepse për vitin në vazhdim, vetëm gjashtëmuorin është diskutuar dhe këtë gjë unë e thashë. Edhe çështjen e investimeve ua përmenda, 15 milionëshin, se duket

sikur po bëjmë debat për një gjë të munguar dhe që nuk e kemi diskutuar kur kemi bërë strukturën. Ne kemi diskutuar dhe ju ratë dakord që me 7 shoferë i plotësoni kërkesat tuaja. Në qoftë se bëhet fjalë për 2 shoferë të tjerë, 9 anëtarë jeni ju, në mos gaboj, por për 4 shoferë të tjerë është një çështje që duhet ta kishit trajtuar që kur sollët strukturën. Unë thashë që strukturën e kemi miratuar me koshiençë dhe ju keni qenë dakord, e kemi ndërruar 2-3 herë dhe ti e di shumë mirë. Problemi shtrohet që në këto momente ne nuk shtojmë dot numrin e punonjësve ose do të ulim numra nga punonjësit e prapavijës ose nga ndonjë institucioni tjetër. Duhet të ulim numrin e punonjësve të një institucioni tjetër në 2-3 vetë, që të realizoni kërkesën që keni. Unë mendoj se në këto momente kjo është e pamundur për t'u bërë. Tani, t'i kërkoj qeverisë të shtojë dy deri në tre shoferë, mua më duket pak absurde, pasi e rëndësishme është që buxheti juaj është në funksion për aktivitetin kryesor, për të cilin jeni krijuar. Në qoftë se vjen këtu dhe thua se nuk e ushtron dot aktivitetin, sepse të mungojnë dy shoferë, kjo është shumë banale dhe unë nuk të dëgjoj fare për këtë gjë. Më falni që po shprehem kështu, por ju kërkuat edhe 4 sekretaret shtesë. Pra, për çdo komision ju doni të keni sekretarë mbi sekretarë. Unë, zoti kryetar, si relator, shpreh mbështetje të jashtëzakonshme për këtë projektbuxhet që ka sjellë Ministria e Financave dhe qeveria, sepse e ka sjellë shumë herë më të lartë, 73% më shumë se vitin e kaluar. Shpresoj që këto shifra, në qoftë se do t'i miratojmë, t'i realizojmë për vitin që vjen, sepse janë shumë i bindur se vitin tjetër do të ketë shifra të përealizueshme. Në qoftë se këto shifra do të realizohen, kërkesa e kryetarit të KLP-së për shtim të punonjësve do të mbetet në diskutim në muajt në vijim për të parë edhe performancën e institucioneve të tjera se sa mund ta bëjnë. Kjo mund të bëhet edhe me vendim qeverie, pra me një shtesë nga fondi i veçantë apo me një ribërje të strukturës së re. Pra, në qoftë se do të sillni një rishikim të strukturës, mendojeni më mirë që t'i realizoni të gjitha gjërat se çfarë ju duhet. Unë këtë mendim kam.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Edhe unë jam dakord me zotin Fino që buxheti i një institucioni ka funksionalitetin e organit kushtetues. Në prezantimin e buxhetit në parim, në seancën e kaluar, Ministria e Financave propozoi që këtij projektbuxheti t'i vihet emri “Buxheti i drejtësisë”, sepse buxheti i vitit 2020 vjen në total me 6,6% rritje vetëm për sistemin e drejtësisë, pra për zbatimin e plotë të sistemit të drejtësisë, si një nga prioritetet kryesore të kësaj qeverie. Më vjen mirë që edhe buxheti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për këtë vit vjen me 73,1% rritje, sipas relatorit Fino, sepse këtu është marrë në konsideratë 6-mujori i dytë i funksionimit të organit. Ne duhet të kemi parasysh se, kur u miratua struktura dhe kur filloi zbatimi i plotësimit të saj, sepse struktura e këtij institucioni është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe sot ka ardhur

projektbuxheti, ne nuk mund të diskutojmë shtim të numrit të punonjësve kur numri total i punonjësve, që do të jenë pjesë e administratës dhe institucioneve kushtetuese ose të krijuara me ligj për vitin 2020 është 82 mijë e 337 punonjës. Unë jam dakord që, nëse gjatë ecurisë së zbatimit të buxhetit të vitit 2020, institucioni do të ketë nevojë të tjera për personel shtesë në funksione të caktuara, pse jo mund të ketë edhe zgjidhje alternative nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave, por, gjithsesi, çështja e strukturës është e mbyllur, sepse sot ne po diskutojmë projektbuxhetin.

Buxheti merr në konsideratë edhe akomodimin në godinën e re. Unë dua të përmend shifrat: një zë buxhetor është 88 milionë e 152 mijë; 20 milionë është zëri tjetër dhe vjen me rritje në 22,1 milionë. Edhe pse buxheti faktik ka qenë rreth 2,2 milionë, rrethanat janë objektive, sepse institucioni është krijuar shumë vonë dhe kemi investime me 17 milionë. Unë u propozoj kolegëve që ne ta miratojmë buxhetin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në këta terma dhe shifra, siç e ka sjellë Ministra e Financave dhe Ekonomisë, duke e lënë edhe hapësirën për strukturën gjatë ushtrimit të vitit buxhetor për vitin 2020.

Zoti Ibrahim, në mos gaboj, kishte një shqetësim lidhur me 3 anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë që u zgjodhën nga Kuvendi i Shqipërisë, të cilët u shkëputën nga sistemi avokatisë, deri në momentin e krijimit të institucionit, për të shmangur konfliktin e interesit. Unë jam njohur me këtë problem, sepse kam pasur herë pas here kërkesa për ta trajtuar këtë çështje, por një klauzolë e ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë thotë: “Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ashtu si edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor konstituohen në momentin që zgjidhet anëtari i fundit i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ose anëtari i fundit i Këshillit të Lartë Gjyqësor”. E thënë më qartë: 3 anëtarët e KLP-së, siç janë edhe 3 anëtarët e KLGJ-së, kërkojnë një pagesë pune nga momenti i zgjedhjes deri në momentin e konstituimit kushtetues të organit. Pra, ata kërkojnë një pagesë për një punë në një organ që nuk ishte krijuar ende. Ky është një ngërç ligjor. Unë e kam dhënë sugjerimin tim, sepse kjo çështje i takon gjykatës ta zgjidhë, por, nëse gjykata e merr në konsideratë dhe iu njeh të drejtën për të pasur trajtim me pagë për këtë periudhë, absolutisht ne jemi dakord. Sigurisht, ne nuk dalim dot mbi vendimin e gjykatës, por zgjidhje tjetër në këtë tryezë nuk mund të bëhet, sepse është një përcaktim i bërë në ligj. A mundet dikush të paguhet për një punë në një organ që u krijua 3 muaj më vonë?! Këtë çështje ne e kemi diskutuar disa herë edhe me Ministrinë e Financave, e cila nuk e merr përsipër ta bëjë një gjë të tillë dhe nuk ka si ta marrë. Gjithsesi, edhe ky problem mbetet për t’u trajtuar, por nuk mendoj se duhet trajtuar te buxheti.

Kështu, unë i ftoj kolegët që ta miratojmë buxhetin me premtimin se Komisioni i Ligjeve do të jetë i hapur në çdo kohë që të ulet me KLP-në, por edhe me organet e tjera të

krijuara rishtazi për shkak të reformës në drejtësi, dhe do të kemi të gjithë disponibilitetin e duhur për ta suportuar deri në fund zbatimin e reformës në drejtësi. Unë jam dakord edhe me relatorin Fino që ky buxhet duhet përshëndetur dhe nuk mendoj se funksionaliteti i një organi kushtetues të pengohet nga personeli mbështetës, në rastin konkret e kam fjalën për shoferët.

Sot janë 6 plus 1, në një moment të dytë pse jo do të ketë edhe shtesa për të pasur edhe një barazi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, sepse, nëse do të akomodohen 11 anëtarët e KLGJ-së me shoferë në strukturë, patjetër që strukturat do të jenë unike dhe unë jam i hapur në këtë pikë. Unë nuk mendoj se në këtë fazë të diskutimit të projektbuxhetit do të pengohet funksionimi i KLGJ-së. A është dakord me relatorin përfaqësues i Ministrisë së Financave?

Vilma Causholli – Ministria e Financave është dakord.

Ulsi Manja - Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Në fakt, zoti kryetar, unë jam anëtar i Komisionit të Ligjeve dhe dua ta them publikisht se nga momenti që privohen të drejtat dhe liritë e kujtdo qoftë vota ime është kundër. Pra, ju lutem, si anëtarë të Komisionit të Ligjeve ne duhet të operojmë me të drejtën që u takon apo nuk u takon. Çfarë është kjo tani? Kanë apo nuk kanë 3 shoferë, mua nuk më intereson fare, është standard ligjor, është standard kushtetues. Pra, nëse u takon, le t'ua japim. Çfarë është kjo? Ne po u lutemi anëtarëve të Komisionit të Ligjeve që ta votojnë apo ta mos e votojnë. A e ka parashikuar buxheti apo jo? Kjo, zotëri, është standard. Unë kështu e gjykoj dhe vota ime është kundër.

Ulsi Manja – Po, patjetër!

Edhe në parim ti ishe kundër projektbuxhetit, kështu që nuk ka asnjë problem, ky është mendimi juaj. Deputetët janë të lirë të votojnë këtu, por buxheti është çështje portofoli: sa lekë janë në portofol, aq do të shpërndahen. Buxheti i shtetit është njëlloj si buxheti familjes, aq lekë sa ke në portofol, me aq do t'ia dalësh në fund të ditës. Ne vijmë me 73,1% ...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, zoti Alimadhi!

Buxheti i KLGJ-së vjen me rritje 73,1%, kurse ti thua...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, vjen më shumë se sa vitin e shkuar.

(Diskutime pa mikrofon)

Ky është mendimi juaj, zoti Alimadhi.

Po, zoti Ibrahim.

Gent Ibrahim – Dua të bëj një koment të fundit. Unë sot jam i papërgatitur për të kundërargumentuar në mënyrë të efektshme për një arsye shumë të thjeshtë. Sot në mëngjes,

jam me fat që e kam marr vesh, se edhe mund të mos e merrja, se këtu do të diskutohej buxheti i KLP-së. Se si dhe pse, është puna juaj, ndaj zgjidheni ju. Para se të ngrini dorën, kujtoni vetëm një gjë: çështjet e statusit nuk janë të diskutueshme. Statusi i anëtarëve të KLP-së është vendosur nga Gjykata Kushtetuese e këtij vendi dhe nuk është i negociueshëm nga ju këtu sot. Kaq.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Sot nuk po diskutojmë statusin e anëtarëve të KLP-së.

Gent Ibrahimi – Të diskutosh për shoferët në një kohë që i kanë të gjithë homologët e tyre, është çështje e statusit që vjen nga ligji për shërbimin e transportit funksional, i konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese.

Ulsi Manja – Zoti Ibrahimi, strukturën e keni dakordësuar ju dhe zoti Fino pak kohë më parë, ndaj kjo nuk është çështje e përgjegjësisë së komisionit. Ju e keni diskutuar bashkërisht çështjen e strukturës.

Gent Ibrahimi – Nëse e ka diskutuar ndonjë që ka ardhur nga rruga dhe nuk e ka diskutuar një njeri që vjen pas një viti në drejtim të institucionit, janë dy gjëra shumë të ndryshme.

Ulsi Manja – Dakord, por kjo është tjetër çështje. Unë mendoj se ju e keni diskutuar strukturën, por, gjithsesi, unë e shpreha qëndrimin tim që jam i hapur për këtë gjë dhe nuk ka asnjë lloj problemi.

Kush është dakord me buxhetin e KLP-së? Zoti Fino?

Dakord!

A është dakord Ministria e Financave?

Dakord!

Gjatë kohës së diskutimit të buxhetit do të kemi një seancë plenare të miratimit në parim dhe më pas do të jetë edhe miratimi nen për nen i buxhetit për secilin nga institucionet, prandaj bëhet dëgjesa sot. Ju i parashtruat nevojat buxhetore, ku pati edhe një diskutim në parim të këtyre nevojave që ju shtruat. Deri në miratimin e buxhetit nen për nen, patjetër që do të jemi korrentë me KLP-në dhe me Ministrinë e Financave, por edhe me relatorin dhe Komisionin e Ligjeve. E thënë më qartë: ne jemi komision për dhënie mendimi dhe, natyrisht që disa nga nevojat që do të marrim në konsideratë, do t'ia përcjellim Komisionit përgjegjës për Financat dhe Ekonominë. Më pas është komisioni përgjegjës ai që do të balancojë buxhetin pas zhvillimit të seancave dëgjimore dhe akomodimit të nevojave të institucioneve të tjera, të cilat janë në fushën e përgjegjësisë së komisioneve të tjera. Gjithsesi, ky debat për buxhetin është normal.

Shumë faleminderit për prezencën sot në komision, zoti Ibrahim, zonja Nano dhe zoti Ndreja! Ne do të jemi në kontakt.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Ne duhet të jemi korrekt, ndaj po ju them se këtë program e kemi bërë që javën e kaluar.

Ulsi Manja – Tani nuk ka debat për atë se është në faqen e Kuvendit.

Bashkim Fino - E kemi bërë që javën e kaluar dhe sot ky nuk mund të më thotë mua që është njoftuar sot në mëngjes. Nëse është njoftuar sot në mëngjes, është gabim, ndaj le mos vinte fare.

Ulsi Manja – Zoti Fino, unë nuk i hyra atij debati dhe a e dini pse?

Bashkim Fino – Këtë gjejeni ju me sekretarinë tuaj.

Ulsi Manja – Nuk u futa në atë debat, sepse kalendari i buxhetit është kalendar i posaçëm, është miratuar në një mbledhje të posaçme të Komisionit të Ligjeve dhe është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Kuvendit që në momentin e miratimit, ndaj institucionet, nëse duan kohë që të përgatiten për projektbuxhetin, njoftojnë nëse nuk do të vijnë. Ne kemi dëgjesë edhe nesër, ndaj mund të ishim njoftuar dhe mund ta shtynim për nesër këtë mbledhje, në mënyrë që ju të kishit kohë të rakordonit disa shifra. Absolutisht unë nuk e trajtova këtë gjë, pasi veprimtaria e Kuvendit është shumë transparente.

Shumë faleminderit, zoti Ibrahim!

Ditë të mbarë!

Vazhdojmë me organet e vetingut, me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Zonja Natasha Mulaj, kryetare e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ka konfirmuar pjesëmarrjen, ndërsa zotëria që ju shoqëron, nëse do që të marrë fjalën, duhet të prezantohet.

Zonja Mulaj, jeni sot në komision për të parashtruar nevojat buxhetore për vitin 2020 që ka institucioni që ju drejtoni. Sa nga këto nevoja janë akomoduar nga Ministra e Financave në projektbuxhetin që juve ju ka ardhur dhe cilat nga këto nevoja nuk janë marrë në konsideratë, të cilat mund t'i parashtroni sot para Komisionit të Ligjeve që ne t'ju suportojmë, sa është e mundur, lidhur me plotësimin e këtyre nevojave.

Fjala është për ju.

Natasha Mulaj - Faleminderit!

Referuar diskutimit që ka të bëjë me miratimin e projektbuxhetit për vitin 2020, në zbatim të pikës 2 të nenit 19 të ligjit 84/2016, ne kemi paraqitur pranë Komisionit të Ligjeve kërkesat buxhetore të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për vitin 2020. Shkurtimisht, pa u futur

në detaje lidhur me këtë projektbuxhet për vitin 2020, unë do të mundohem të paraqes disa kërkesa ose shqetësime.

Së pari, nevojat për plotësim që kanë të bëjnë me fondin e pagave për gjyqtarët, anëtarët e njësisë së shërbimit ligjor dhe stafit administrativ. Dua të theksoj se përgjatë vitit 2018 në përllogaritjen e fondit të pagave nga Ministria e Financave kanë qenë të përfshira edhe komponentë të shtesës për vështirësi dhe vjetërsi për anëtarët e njësisë së shërbimit ligjor dhe, për rrjedhojë, nuk kemi pasur probleme lidhur me këtë fond. Në përllogaritjen e fondit të pagave në buxhetin e miratuar për vitin 2019 shtesat e mësipërme që janë vështirësi dhe vjetërsi për anëtarët e njësisë së shërbimit ligjor nuk janë përllogaritur në fondin e pagave dhe, për rrjedhojë, buxheti i miratuar ka qenë i pamjaftueshëm për plotësimin e nevojave të Kolegjit. Domethënë, nuk kemi pasur fondin e pagave për dy muajt e fundit, nëntor dhe dhjetor të vitit 2019. Këtë shqetësim e kemi trajtuar në vazhdimësi përgjatë vitit 2019. Për përllogaritjen e fondit të pagave për vitin 2020 kërkojmë që në këtë fond të përfshihen edhe komponentët si më poshtë: shtesë për vështirësi në punë të këshilltarëve. Këtu dua të theksoj se këshilltari ligjor dhe ai ekonomik përfitojnë 80% të pagës mujore përkatëse të anëtarit të institucionit të rivlerësimit. Ata përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë, sipas rastit. Dua të theksoj përsëri se Ministria e Financave nuk e ka përllogaritur këtë vështirësi për shkak të mungesës së një akti nënligjor. Më vendimin nr. 17 të vitit 2019 mbledhja e gjyqtarëve ka miratuar kriteret për dhënien e kësaj vështirësie, në bazë të nenit 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, të cilën ia kemi përcjellë Ministrisë së Financave, ku ndër të tjera është përcaktuar se vlera e kësaj vështirësie nuk duhet të kalojë tri paga mujore në vit. Mënyrën e përcaktimit të dhënies së kësaj vështirësie do ta vendosë vetëm mbledhja e gjyqtarëve.

Së dyti, kërkojmë që të aplikohet dhe të akordohet shtesë për vjetërsi në punë për këshilltarët e njësisë së shërbimit ligjor. Nga projektbuxheti që na është dërguar nga Ministria e Financave, vëmë re se fondi i pagave për vitin 2020 është i njëjtë me vitin 2019, që do të thotë se problematikat që kemi pasur përgjatë viti 2019 do të përsëriten edhe për vitin 2020. Në këto kushte, kërkojmë miratimin e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Kolegji.

Së treti, kërkojmë shtesë në strukturën organike. Kryetari i Kolegjit, që ushtron njëkohësisht edhe detyrën e gjyqtarit relator në të njëjtën masë ngarkesë me anëtarët e tjerë të Kolegjit, kryen edhe funksione administrative dhe detyra të përcaktuara nga neni 13 i ligjit nr. 84/2016. Kompetencat e kryetarit të Kolegjit që parashikohen në këtë ligj janë të shumta. Në këto kushte, kur ngarkesa e punës po shtohet çdo ditë, detyrat e lëna nga mbledhja e gjyqtarëve janë të shumta. Marrëdhëniet me të tretët, siç janë bashkëpunimet me institucionet e treta dhe me ONM-në, drejtuese e të gjitha shorteve që zhvillohen në Kolegj, trajtimi i çdo kërkesë që

futet në Kolegj e të tjera, e bëjnë shumë të ngarkuar punën e kryetarit të Kolegjit. Në këto kushte, kërkojmë ndryshimin e strukturës organike, duke krijuar kabinetin e kryetarit të përbërë nga dy punonjës, drejtorë kabineti dhe këshilltari i kryetarit. Këtë kërkesë, zoti Kryetar, e kemi përcjellë gjithmonë. Sa herë kemi ardhur këtu, kemi kërkuar shtim kabineti, është hera e tretë ose e katërt nëse nuk gabohem që e kërkojmë. Tani po e kërkojmë më shumë se asnjëherë tjetër pasi, në të vërtetë, çdo ditë e më shumë po shtohet detyra e kryetarit të Kolegjit.

Meqenëse jemi te pika e strukturës organike, do të kërkonim që të ndryshojë kjo strukturë në kategorinë e pagës nga “4A” në “3B” për 3 punonjësit specialistë të redaktimit të vendimeve, të pritjes me popullin dhe të arkiv protokollit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe në përputhje me Gjykatën Kushtetuese.

Së katërti, ne kërkojmë shtesë për natyrë të veçantë pune për stafin administrativ. Për këtë, konkretisht po ia kaloj fjalën drejtorit Ekonomik të Kolegjit, zotit Dritan Baji, për arsyen pse e kërkojmë këtë shtesë për natyrë të veçantë pune.

Dritan Baji - Përshëndetje, i nderuar Kryetar!

Përshëndetje të nderuar anëtarë,

Pas pikave që renditi kryetarja, ne kemi paraqitur edhe një kërkesë që ndoshta nuk është pikërisht për Komisionin e Ligjeve, por ndoshta mund të negociohet, sepse zakonisht kërkesat për shtesë natyre të veçantë pune dalin me vendim të Këshillit të Ministrave, por, gjithsesi, ne e kemi parashtruar si kërkesë te ju, meqenëse ligji nr. 84/2016 na referon që ne kërkesat tona i paraqesim pranë Komisionit të Ligjeve.

Ideja është se nga fillimi i funksionimit të institucionit deri në momentin që ne flasim jemi përballë dhe vazhdojmë të përballemi me dorëheqje të shpeshta të stafit administrativ, që po të llogariten në përqindje, rezulton se gjatë kësaj periudhe rreth 40% e stafit kanë dhënë dorëheqjen, domethënë, kanë aplikuar, janë shpallur fitues, janë punësuar dhe pas një periudhe relativisht të shkurtër kanë dhënë dorëheqjen, ku dorëheqja është dhënë pothuajse gjithmonë nga pakënaqësia që kanë ndaj pagave. Domethënë, në momentin që janë ballafaquar me ngarkesën që ka institucioni, me mënyrën se si punohet dhe me kërkesat që trupa e kolegjit ka për secilin punonjës, ata e kanë parë të arsyeshme që kjo pagë nuk është e mjaftueshme për impenjimin që kërkohet për gjithsecilin prej tyre. Në këto kushte, duke marrë shkas edhe nga aktet ligjore që janë në fuqi, kemi vënë re që në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.187, i cili miraton strukturat dhe nivelet e pagave për nëpunësit e Republikës së Shqipërisë, disa institucione konsiderohen të një natyre të veçantë dhe stafi i tyre administrativ përfiton një shtesë thjesht për faktin se këto institucione konsiderohen si të veçanta. Unë po citoj disa prej këtyre institucioneve: DAP-i, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, AKSHI, Drejtoria e

Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave e të tjerë. Kolegji i Apelimit, por besoj se edhe kolegët, të cilët i përkasin institucionit të rivlerësimit, pasi ne jemi konsultuar me njeri-tjetrin paraprakisht dhe besoj se edhe ata do ta ngrenë këtë shqetësim, kemi kërkuar mundësinë e përcaktimit si pjesë e pagës mujore për administratën dhe të një shtese të ndarë me kategori për secilën nga drejtoritë, konkretisht: Kolegji i Apelimit ka dy drejtori, ajo e Menaxhimit të Çështjeve, ku kemi kërkuar të kemi një shtesë prej 20 mijë lekësh në muaj për person, dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse një shtesë prej 10 mijë lekë për stafin, si dhe një shtesë për sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtoreshën e Menaxhimit të Çështjeve si pika kyçe që ndihmojnë procesin, ose organizojnë të gjithë procesin e vlerësimit deri në momentin e gjyqimit. Këto kisha për t'ua bashkëngjitur shqetësimeve që shprehu kryetarja, para se të hyjmë në nivel shifrash.

Ulsi Manja- Po, faleminderit!

Dritan Baji - Kemi edhe një pikë tjetër shtesë, atë të rishikimit të vështirësisë për gjyqtarët. Pa u zgjatur shumë, dua të them se diferencën e pagës që anëtari i KPA-së ka me atë të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese e bën vështirësia. Që në janar të vitit 2019 dhe deri tani paga e anëtarit të KPA-së është e njëjtë me atë të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, domethënë paga e anëtarit të kolegjit është e njëjtë me pagën e subjektit. Diferencën që e bën këtë pagë është vetëm vështirësia që ne marrim. Në këtë rast ne kërkojmë rishikimin e kësaj vështirësie që të rritet. Ne marrim një vështirësi deri në 50% të pagës dhe kërkojmë rritjen e kësaj përqindjeje.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Po, zoti Fino.

Bashkim Fino- Kryetar, më vjen keq që duhet ta them, e kam për të gjithë, jo vetëm për KPA-në, por edhe për ata që kanë kërkuar, por këta sa vjen dhe kërkojnë. Më e bukura është se këta nuk kërkojnë për vete, por për stafin ndihmës, për këshilltarët ekonomikë dhe për pjesën tjetër, ndërkohë që ligji e ka një paragraf për dhënin e shpërblimeve, ndaj i thashë këshilltares sime ta sjellë, sepse më duhet ta lexoj tamam, por sa ta sjellë, sepse këta mezi punojnë, duhet të punosh vetë. Kur ligji në bazë të atij neni thotë që duhet të marrësh shpërblim, nuk do të thotë që ti të mbledhësh kolegjin e të vendosësh për vështirësinë e gjyqtarëve sesi do të vlerësohen. Ai vendim që ju keni bërë, më falni e kam personale, për mua, meqenëse jam financier, është i gabuar, sepse ju nuk keni tagër që të mblidhni kolegjin dhe të vlerësoni, në vendimin e kolegjit tënd, sepse ju nuk jeni zgjedhur për këtë punë, por jeni zgjedhur për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, se kur është vështirësia e një punonjësi të saj dhe kjo ta vlerësojë deri në tri paga. Jo, absolutisht jo, sepse është detyrim,

sipas ligjit që ju takon dhe ligji e ka, një VKM e qeverisë, ose një udhëzim i Ministrisë së Financave. Unë jam dakord që qeveria të nxjerrë urgjent një vendim qeverie në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave, ku të thotë që shpërblimi për punonjësit e të tria institucioneve tuaja...

Neni 29 i ligjit tuaj, pika 5, thotë: “Këshilltari ligjor dhe ekonomik përfiton përkatësisht 80% të pagës mujore përkatëse të anëtarit të institucionit të rivlerësimit. Ata përfitojnë një pagë shtesë për shkak të vështirësisë sipas rastit”. Çfarë do të thotë sipas rastit?! Për këtë dhe për nenet e tjera duhet të bëjë një akt nënligjor qeveria, por deri në këto momente, me sa di unë, qeveria nuk e ka bërë këtë dhe ka bërë gabim. Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë duhen urgjentisht të përgatitin një akt nënligjor për të vlerësuar shpërblimet e punonjësve tuaj. Unë si financier në atë vendim do të thosha: “Urdhërojmë që punonjësit tuaj mund t’i shpërbleni deri në dy paga apo tri paga në vit për punë të mirë” dhe ta lë në legjislacionin tënd. Pra, unë, si qeveri, e miratoj këtë dhe në momentin që unë e kam miratuar e do të shpërblehet deri në dy paga, do të thotë që Ministria e Financave të bëjë llogaritjet me përafërsi, me mesatare, për ta paraqitur atë në projektbuxhetin e vitit që vjen. Pra, përveç pagës, ai mund të marrë deri në dy paga, në vlerësimin tuaj, pastaj mund të thuash ti që për mua ky këshilltar ka punuar më mirë për një çështje të caktuar dhe e vlerësoj nga një deri në dy paga. Pra, ti ke të drejtë të vlerësosh nëse do ta shpërblesh me 1 ose 2 paga, sepse nuk është taksative. Këtë vendim duhet të marrë qeveria. Qeveria duhet të vlerësojë dhe të nxjerrë aktin nënligjor në funksion të pikës 5 të nenit 29, ku të thotë që gjatë vitit drejtuesi mund të marrë 1-2 paga shpërblim për punë të mirë. Domethënë, ta lë në dorë ty të vendosësh, ku dysHEMEJA do të jetë një pagë dhe TAVANI deri në dy paga. Ky është vendimi që e kompletton këtë ligjin tënd dhe nenin tënd, por jo vendimi që ke marrë ti, më falni që po ndërhyj, por është çështje financiare dhe jo juridike, nuk e ezauron problemin e ligjit, sepse ligji nuk e cakton që ta marrësh ti vendimin, pasi çështjet financiare trajtohen nga qeveria e Ministria e Financave dhe fatura financiare është gjithmonë e qeverisë. Edhe unë këto që po diskutoj me ju, ku ti mund të kesh të drejtë për çdo çështje që ngre, do t’i trajtoj në Ministrinë e Financave, nëse është e mundur t’i trajtoj këto gjëra. Kjo është çështja e parë.

Unë mendoj, zoti kryetar, e kam lexuar me kujdes materialin që Komisioni i Apelitimit ka trajtuar lidhur me përfitimin e shtesës së veçantë, se kërkesa për rritjen e nivelit të shtesës për vështirësi dhe shpërblimin e vështirësisë për këshilltarët e njësisë së shërbimit ligjor më duket absurde. Kryetar, a e di se çfarë thonë këta?! Këta thonë që këshilltari, i cili punon tek unë, ka vështirësi dhe, meqenëse ka vështirësi, unë duhet t’i jap lekë më shumë, por unë personalisht nuk jam dakord për këtë. Unë si ligjvënës, kur të kam krijuar ty si institucion, të

kam dhënë të gjitha të drejtat legjitime që ka ligji, ku kam futur shoferët, rrogat dhe të gjitha, por të vish e të kërkosh rritje të numrit të punonjësve dhe të vështirësisë së këshilltarëve, kur unë bashkë me ju kur kemi miratuar strukturën e kemi gjykuar që kaq do ta keni fondin e pagave, më duket absurde. Kjo është njësoj sikur të ngrihem unë këtu dhe të them që këshilltarët e Kuvendit të Shqipërisë kanë vështirësi në punën e tyre, që, në fakt, kanë vështirësi, sepse na këshillojnë ne që vendosim dhe miratojmë ligjet që do të zbatohen nesër. Pra, të ngrihem unë dhe të them që dua t'ia rrit rrogën këshilltarit të Kuvendit, sepse ka vështirësi, mua më duket absurde, pasi, kur kam ardhur këtu si deputet, nuk kam ardhur për t'ua rritur rrogën këshilltarëve, por kam ardhur të bëj punën time ndaj zgjedhësve. Edhe ju jeni votuar të bëni punën tuaj për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të cilin jeni krijuar dhe nuk shkoni atje të thoni, siç tha drejtori juaj ekonomik, që na kanë ardhur njerëzit dhe kanë ikur nga puna, sepse nuk duan të rrinë, le të mos rrinë, vijnë të tjerët. Kjo punë është me dëshirë, sepse mund të ketë njerëz që kanë performancë të lartë dhe duan të shkojnë në një vend tjetër, le të shkojnë.

Po të shohim fondin e pagave dhe pagat në tërësinë, ju duhet të jeni shumë të kënaqur. Unë kam vënë re, sepse ju kam ndjekur vetë dhe kam qenë relator kur kemi miratuar strukturën, që ju nuk kërkon për vete, por kërkon për pjesën ndihmëse dhe për njerëzit e tjerë. A doni t'ju kthej përgjigje zyrtare për këtë letër që keni bërë?! Po jua kthejmë që të jetë në procesverbal:

Lidhur me përfitimin e shtesës me natyrë të veçantë, mbajini me kujdes shënim, sepse kjo është përgjigjja ime intelektuale edhe si ekonomist, por edhe si deputet, pastaj këta të bëjnë çfarë të duan, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka kërkuar pagë shtesë për natyrë të veçantë pune për pozicionin e sekretarit të Përgjithshëm; ka kërkuar shtesë për drejtorin e Menaxhimit të Çështjeve dhe të Marrëdhënieve me Medien dhe Publikun, në vlerën 25 mijë lekë; për punonjësit e drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve të Marrëdhënieve me Medien dhe Publikun, në nivelin 20 mijë lekë; për punonjësit e Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimit të Mbështetjes, në nivelin 10 mijë lekë. Kërkesa e KPA-së argumentohet me faktin: a) KPA, si i vetmi organ gjyqësor i procesit të rivlerësimit kalimtar, ushtron veprimtarinë me intensitetin e shtuar pune për zbatimin e ligjit nr.84/2016 për të adresuar rekomandimet e Komisionit Europian. b) Në fazën në të cilën ndodhet procesi i rivlerësimit kërkohet mobilizim më i plotë dhe i motivuar profesional i burimeve njerëzore kalimtare. c) Nga fillimi i funksionit të institucionit, rreth 40% e stafit kanë dhënë dorëheqjen si pasojë e pakënaqësisë ndaj shpërblimit financiar. ç) Personeli i KPA-së është i pajisur me certifikatë sigurie për njohjen me informacionet e të tjerë. Në këtë këndvështrim të argumentuar më sipër, shprehemi se shtesa për natyrë të veçantë pune nuk përbën një komponent permanent dhe të vazhdueshëm të pagës. Ajo është e lidhur me kryerjen

e disa funksioneve dhe detyrave specifike me një natyrë të veçantë për ushtrimin e të cilave vlerësohet të akordohet një shpërblim i caktuar. Aktualisht, shtesën për natyrë të veçantë pune në institucionet e administratës publike e përfitojnë vetëm disa pozicione, si: punonjësit e teknologjisë së informacionit, punonjësit e agjencisë së inteligjencës dhe sigurisë së mbrojtjes, si dhe disa pozicione që ushtrojnë funksione politikëbërjes në institucionet specifike, sipas legjislacionit që i ka njohur kompetencat specifike. Pozicionet për të cilat kërkohet shtesë për vështirësi, jashtë pozicionit që ushtrojnë funksione dhe detyra administrative dhe të shërbimit, nuk ushtrojnë funksione të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të kompetencave të ligjit nr.84/2016, që ka njohur Komisioni i Posaçëm i Apelit. Çfarë kërkojnë ata?! Ata nuk kërkojnë për atë çfarë e kemi krijuar këtë institucion, por kërkojnë që të rriten rrogat për të tjerët, në vlerën 25 mijë, 20 mijë dhe 10 mijë lekë. Sjellim në vëmendjen tuaj se shtesat në nivelin e kërkuar për natyrë të veçantë pune do të sillnin edhe një deformim të të gjithë piramidës së pagave, pasi paga e sekretarit të Përgjithshëm në KPA-së do të tejkalonte pagën e çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me institucionet kushtetuese, si :Kuvendi, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Ministrave, Avokati i Popullit e me radhë. Pra, këta kërkojnë një super pagë për sekretarin e tyre të Përgjithshëm në funksion me të gjitha këto struktura të ligjëbërjes që kemi ne, si: Kuvendi, Presidenca e kështu me radhë. Ne nuk mund të bëjmë një deformim dhe është absurde të kërkonim shtesë page për sekretarin e Përgjithshëm, ku sekretari i Përgjithshëm është në një nivel me atë të Kuvendit, të Presidencës, të Këshillit të Ministrave e kështu me radhë.

Lidhur me rrjetin e nivelit të shtesës për vështirësi. KPA-ja ka kërkuar rivlerësim në drejtim të rritjes së masës së shtesës për vështirësi, në mënyrë që kjo shtesë të bëjë diferencën midis zyrtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe subjektit të vlerësimit. Fillimisht vlerësojmë të nënvizojmë faktin se në zbatim të kornizave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, që u ka njohur anëtarëve të organeve të rivlerësimit kalimtar të drejtën e përfitimit të shtesës për vështirësi, Këshilli i Ministrave, bazuar në propozimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, ka miratuar vendimin, që e cilësuat edhe ju, zonjë, nr.547, datë 09.10.2017. Ky vendim parashikon se paga mujore shtesë për vështirësi përllogaritet në masën 50% mbi pagën bruto fillestare për çdo anëtarë të institucionit të rivlerësimit, e cila llogaritet mbi bazën mujore. Në shifra kjo shtesë llogaritet në masën 121643 lekë në muaj për anëtarët e KPK-së dhe IKP-së e kështu me radhë.

Në këndvështrimin tonë dua t'ju them se nocioni shtesë për vështirësi mbi pagë shpreh një komponent të pagës për funksion. Ky parim është materializuar dhe ka parashikim ligjor në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Duke iu referuar nenit 12 për caktimin e pagës së magjistratit, parashikohet se paga e magjistratit përbëhet ndërmjet të tjerash edhe nga elemente shtesë për vështirësi dhe, për rrjedhojë, shpërblimi për vështirësi është konceptuar në formën e një shtese, element i pagës. Në praktikën e deritanishme shtesat për vështirësi janë përcaktuar në përqindje mbi nivelin e pagës referuese në ligjin nr.8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, të shfuqizuar, ku prokurori me propozim të eprorit dhe me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm mund të përfitojë deri në 20% shtesë pagë për vështirësi pune. Kjo dispozitë ka qenë e aplikueshme deri në datën 01.01.2019. Gjithashtu, në ligjin nr. 9877/2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor” të shfuqizuar”, neni 26, pika 2, parashikon që gjyqtari i Shkallës së Parë dhe Krimet e Rënda përfiton 10% shtesë mbi pagën për funksion për kushte të veçanta pune, në rastin e SHISH-it është 50%. Në përcaktimin e një shtese për vështirësi për institucionet e vlerësimit kalimtar ligjvënësi ka synuar, pra, ne kemi synuar, të përmirësojë në mënyrë rrënjësore trajtimin financiar të tyre, me qëllim që t’i mbrojmë ata nga presioni që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e ushtrimit të funksionit të tyre. Aktualisht, në sistemin e hierarkisë së pagave, anëtarët e KPA-së trajtohen financiarisht në mënyrë të njëjtë me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, paga e të cilëve përbëhet nga paga e lartë në piramidën e pagave të Republikës së Shqipërisë, ndërsa shtesa që kërkon ju i kalon caqet mbi 4 milionë lekë. Më lejoni t’ju sjell në vëmendjen tuaj edhe dy shifra, që i kam trajtuar edhe në Ministrinë e Financave dhe dua t’i trajtoj edhe me ju.

Zonjë, ne miratojmë nenin 12...

Ulsi Manja – Më falni, është i njëjti debat që kemi edhe me dy organet e tjera, por ta shterojmë këtu.

Bashkim Fino – Prandaj po i them, sepse nuk do të flas për këtë çështje. Kjo është çështje e qeverisë dhe, nëse e sjell ajo aktin nënligjor, unë jam i detyruar që ata ta marrin këtë shpërblim, por kur ta sjellin ata dhe jo ta merrni vendimin ju. Në momentin që vendimi del nga qeveria, automatikisht Ministria e Financave i ka të gjitha detyrimet që ta pasqyrojë këtë vendim me fond page dhe nuk diskutohet. Në qoftë se qeveria thotë që unë do ta shpërblej punonjës në një deri në dy paga, në moment kjo hyn në fuqi dhe Ministria e Financave është e detyruar ta respektojë këtë vendim qeverie dhe të parashikojë për vitin 2020 të gjithë fondin e nevojshëm të shpërblimit, pastaj jeni ju që ta vendosni se sa do të jepni shpërblim. Kjo është çështja që duhet të diskutohet.

Dua t’ju them diçka, të tre ju drejtuesve, sepse jeni intelektualë dhe shqiptarë dhe i dini çështjet financiare dhe juridike shumë më mirë edhe se unë. Ne kemi një nen 12 të projektbuxhetit, të cilin do ta miratojmë, që thotë: “Paga e Presidentit të Republikës është 257

000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Pse e ka lënë këtë nen Presidenti i Republikës dhe e miraton parlamenti?! Ne e kalojmë këtë për të treguar që kjo është paga e nivelit më të lartë në mënyrë hierarkike dhe pas kësaj page janë të gjitha pagat e tjera të Kryeministri, të Kryetarit të Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese, deputetit, prefektit, kryetarit të bashkisë e të tjerë me radhë. Ne, me krijimin e institucioneve tuaja dhe me krijimin e reformës në drejtësi kemi bërë një ndryshim shumë të madh dhe e kemi bërë vitin e kaluar. A e dini cili është ndryshimi?! Është kjo lista që kam unë para, zotërinj, për pagat që merrni ju të gjithë, të gjithë gjyqtarët dhe ata që nuk kanë kaluar në filtrat tuaj, po jua lexoj unë: kryetari i Gjykatës së Lartë e ka 326665 lekë; kryetari i Gjykatës së Krimeve e ka 326665 lekë; kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe apeleve të tjera e ka 316272 lekë; zëvendëskryetarja e Gjykatës së Lartë e ka 302690 lekë; të tjerët po i përmend vetëm si emra: gjykata e krimeve, gjykata e rrethit të krimeve, gjykata e apelit, zëvendëskryetari i apelit të krimeve, kryetari i gjykatës së rrethit, gjyqtari i apelit të krimeve, zëvendëskryetari i apelit, gjyqtar apeli, gjyqtar rrethi, zëvendëskryetar rrethi, kryetari i rrethit të Tiranës dhe shkalla e parë administrative marrin pagë 265725 lekë. Këta, zonjë, janë një fashë pre 790 vetash, nga të cilët 472 janë gjyqtarë dhe 318 prokurorë, të cilët janë mbi piramidën e pagës së Presidentit të Republikës. Unë miratoj vlerën 257 mijë, por, në fakt, kam një piramidë të tërë, që e kam miratuar me koshiençë për të marrë një pagë më të lartë. Problemi është që pagën e lartë e marrin edhe ata që nuk kanë kaluar në tri filtrat tuaja, të cilëve mund t’u ndodhë t’u thuhet këmba e të mos e kalojnë filtrin tuaj dhe padrejtësisht ata gëzojnë këtë pagë, që normalisht nuk duhet ta gëzonin, por duhet ta kthenin, ose të merrnin pagën e vjetër dhe në momentin që kalonin në filtrat tuaj dhe e fitonin të drejtën, qoftë për anën profesionale, si dhe atë financiare, atëherë ta rimerrnin pagën që u takonte, por ne jemi dorëlëshuar dhe kemi thënë që gjyqtarët dhe prokurorët të marrin të gjitha lekët, ndërkohë ju vazhdoni punën tuaj normale dhe nxirrni disa skarco dhe disa joskarco. Pse ai që del skarco e ka marrë rrogën padrejtësisht deri tani në nivelin më të lartë se të Presidenti i Republikës?! Pra, dua t’ju them se sistemi i pagave në Republikën e Shqipërisë është një sistem financiar që ka të drejtë ta menaxhojë Ministria e Financave dhe qeveria, sepse janë lekë, nuk është dëshirë. Unë jam me të dyja duart dhe plotësisht dakord me gjykimin tuaj që nenin 29 pika 5, zoti kryetar, ne duhet të kërkojmë dhe këtë e kam kërkesë zyrtare, urgjentisht nga Ministria e Financave dhe nga Ministria e Drejtësisë që brenda këtij viti të nxjerrin aktin nënligjor. I takon në funksion të nenit kaq dhe ju të tre duhet të ishit bërë bashkë me një shkresë përcjellëse dhe t’ia dërgonit Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit dhe t’u thoshit: “Unë dua aktin nënligjor”. Akti nënligjor të jep mundësinë që të marrësh dhe çështjet e prapambetura, por pa akt nënligjor t’i

sapo më the mua zonjë dhe më lejo të them se keni bërë një gabim financiar. Unë po të isha Kontrolli i Lartë i Shtetit, do ta gjeja me shkelje drejtorin tënd financiar. E di pse do ta gjeja me shkelje?! Sepse jam financier. Dua të them një gjë: “Ti më thua që nuk kam fond page për 2 muajt e fundit”. E dini pse nuk ka fond page për dy muaj e fundit?! Sepse ka dhënë 3 paga shpërblim, ka respektuar nenin që është këtu, që nuk ka dalë akti nënligjor, ka marrë një vendim vetë dhe ka dhënë shpërblim. Natyrisht, shpërblimin e ka dhënë nga fondi i pagave, e ka harxhuar fondin e pagave që ishte planifikuar për 12 muaj, u ka dhënë shpërblim njerëzve dhe tani në fund thotë: “Nuk kam lekë për këto 2 muaj”. Po kush je ti që jep shpërblimin, kur nuk ka një akt nënligjor?! Unë i gjeja shkelje ligjore drejtorit tënd të financës, që nuk duhet të bëjë kurrë veprime të kësaj natyre pa e mbështetur me akte nënligjore. E keni në ligj?! Nxirreni! Pse i ke dhënë 3 paga atij? Unë mund të jap edhe 5 si vendime qeverie nesër. Ku e di ti që do të jenë 3 paga? Mund të jenë edhe 2 paga, mund të jetë 1 pagë, mund të jenë 5 paga shpërblimi, ti ke dhënë 3 paga. Ku i gjete këto 3 paga që i keni dhënë? Pra, realisht ti nuk e ke zbatuar ligjin në rastin konkret, padrejtësisht ke dhënë shpërblime dhe sot ke ngelur 2 muaj paga. Të vish në komisionin tim dhe të më thuash që unë kam ngelur 2 muaj paga, mua më duket absurde dhe nuk mund ta pranojë këtë. Unë të kam miratuar vitin e kaluar dhe unë kam qenë korrekt dhe kemi ngritur të gjithë duart lart dhe kemi thënë në rregull, ky është buxheti juaj, ta gëzoni e të tjera me radhë. Të vish tani dhe të më thuash kam ngelur pa paga, mua nuk më duket korrekte.

Prandaj unë, në përfundim kam këtë sugjerim, zoti kryetar: fondet e tyre janë të sakta, duhet të rishikohen dhe një herë, por mendoj se këta i kanë fondet e qarta, sepse kanë numrin ekzakt. Nuk kanë nevojë që të ketë ndryshime të tilla. Duhet të bëhet një kontroll financiar tek të tria institucionet dhe në qoftë se nuk e bën Kontrolli i Lartë i Shtetit, duhet ta bëjmë si parlament i krijuar, të ngremë një komision, të bëjmë një kontroll financiar të fondeve, sepse i japim ne fondet dhe lekët, dhe janë lekët e taksapaguesve shqiptarë. Ajo që u takon me ligj ta gëzojnë deri në një nuk kam asnjë vërejtje, ajo që u takon me vendim qeverie ta marrin deri në një. Ajo që nuk u takon, ta kthejnë sa më shpejt, në qoftë se e kanë marrë padrejtësisht. Kështu po mbyll. Me të tria këto shifra këtu jam plotësisht dakord, por pasi të dalë vendimi i qeverisë. Me këtë vendim qeverie, që nuk ka dalë dhe me këto argumente që sapo i lexova dhe i kam të detajuara këtu, mendoj se këta nuk i përfitojnë dot këto gjëra që kërkohen sot, nuk i përfitojnë dot për shkak të vendimit jo se nuk dua. Prandaj, ju lutem, merruni edhe ju më shumë me këtë çështje, të dalë vendimi i qeverisë për shpërblimet që këta të mos kenë asnjë lloj problemi me pagat. Nuk do të ketë, sepse ne ia kemi dhënë me koshiençë. Ne sapo i dhamë KLGJ-së më shumë fonde, ne i dhamë më shumë fonde KLP-së. E dëgjuat ju kërkonte shofer KLP-ja? Kërkonte 3 shoferë, sepse fondet i kishte. Kështu edhe të gjithë institucionet e tjera. Nuk shkon

të mos iu japim fonde 3 institucioneve të rivlerësimit që ne duam që jo vetëm të kenë fonde, por të na bëjnë punën me efektivitet, por kjo nuk ka lidhje me këtë se jemi në buxhet tani. Ne ta mbarojmë këtë proces që kjo listë e gjatë, që përmenda, të bëhet efektive për të gjithë shqiptarët dhe nuk duhet për këta, sepse mua më dhemb si ekonomist, që shumë nga këta marrin rrogën dhe dalin në veting në vitin 2020 apo në vitin 2021. Ai do ta marrë rrogën e lartë; më shumë edhe se Presidenti i Republikës dhe do të vetohet në vitin 2021 apo 2022. Në vitin 2021 apo në vitin 2022 ai mund të ikë fare, sepse nuk dihet se çfarë del dhe ai padrejtësisht ka marrë nga 2-3 vjet një rrogë, me cilën ju vlerësojmë ju me që bëni rivlerësimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Kolegët, a kanë pyetje për buxhetin? Nuk kanë pyetje.

E keni diskutim? Ju lutem, shkurt, sepse ne këtë seancë kemi pyetje-përgjigje, sepse janë shifra buxhetore.

Urdhëroni!

Alket Hyseni – Në fakt, nuk doja të replikoja më parë për KLP-në.

Së pari, proceduralisht, dua t'i ftoj institucionet që këtu të vijnë të përgatitura dhe të shpërndajnë kërkesa edhe për deputetët, sepse nuk i kemi materialet para dhe e bazojmë gjykimin tonë vetëm në çfarë dëgjojmë këtu. Për shembull, ka institucione serioze që prezantojnë këtu dhe kjo është meritë e atyre institucioneve që e kanë kuptuar që administrata që është aty, nuk është për t'u përkëdhelur, por është për t'u shtrydhur që, kur të vijnë këtu në Kuvend të vijnë të përgatitur, sepse këtu vihet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Nuk janë institucione që nuk varen nga askush. Ne u kemi dhënë pavarësi të plotë, që të bëjnë detyrën dhe të zbatojnë ligjin të pavarur, por, kur vihet këtu, vihet në tempullin e demokracisë dhe të vini të përgatitur, jo ju, më falni, them për institucionet, por po u drejtohem edhe medieve. Vijnë jo me prezantimin e duhur as në estetikë, pale më pas në përmbajtje. Nga ana tjetër, dua të ftoj sekretarinë që ato institucione, që kanë sjellë materiale, t'u bëhen me dije kolegëve deputetë menjëherë sapo të vijnë. Kjo është kërkesë.

Së dyti, duke e mbështetur kolegun Fino, që në përgjithësi, rrallë ndodh që ne nuk jemi në një mendje, në argumentet e tij, më lejoni që të ndaj mendime ndryshe për sa i përket rolit që kemi ne si Komision Ligjesh. Ne nuk jemi Komisioni i Ekonomisë, nuk jemi as Ministria e Financave. Ne vërtet që jemi në maxhorancë dhe jemi detyruar që këmbët t'i shtrijmë sa kemi jorganin, por duhet të ndajmë se cilin jorgan duhet të përdorim për ato kërkesa që ka ligji. Ato gjëra që ua kemi dhënë me vullnet politik sikurse e tha edhe zoti Fino. Duhet

të gjejmë këtu ne Ministria e Financave Komisioni i Ligjeve zgjidhje patjetër çdo kërkesë, që ka lidhje me statusin, qoftë edhe për shofer. Jam kundër qëndrimit të mëparshëm. Ne duhet t'ua plotësojmë, sepse kemi dalë para shqiptarëve dhe u kemi thënë: kjo është nëna e të gjitha reformave dhe u kemi dhënë lekët. Lekët janë në buxhet dhe digjen në fondin rezervë në organet e drejtësisë, për shkak të mosplotësimit të kuorumeve të vakancave të tyre për elemente të tjera, por ne nuk mund të vijmë këtu dhe të themi se i shikojmë rrugës. 3 shoferë, 3 shoferë, 1 shofer, 1 sekretare, që u takon me ligj, një sekretare, një këshilltar më tepër, po të kërkojnë dhe u takon me ligj, duhet t'ua japim. Këtu duhet të ndajmë këto kërkesa që janë ligjore dhe i kemi marrë për bazë dhe kur kemi ardhur dhe kemi diskutuar ligjet këtu, shpesh jam ngritur dhe i kam thënë Ministrisë së Financave se çfarë mendimi keni ju. Jo më kot i kërkohet Ministrisë së Financave mendim, sepse ajo ka faturën nesër dhe nuk mund ta thotë kur bëhet ligji në rregull dhe më pas, kur vjen për zbatim ligji, të themi, jo ta shtyjmë, jo ta bëjmë, jo rrugës. Ta japim çdo gjë që e kanë me ligj, e meritojnë, se nga vetja e kanë, nga ne, nga populli shqiptar, për të bërë atë detyrë që u kanë dhënë.

Nga ana tjetër, duhet të ndajmë kërkesat e pabaza. Këtë e bëjmë ne. Ky është roli ynë. Ne nuk jemi apendiksi i Ministrisë së Financave këtu. Ne jemi për t'i sugjeruar Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe ministrisë. Ndoshta këta nuk i marrin për bazë të gjitha, por ne jemi avokati i gjithë këtyre institucioneve që vijnë te ky komision, kanë varësi parlamentare apo nuk kanë varësi, por janë të lidhura me raportimin te ky komision, që ne kërkesat e tyre legale t'i prezantojmë, t'i mbështesim dhe t'u sugjerojmë organeve të tjera që t'i plotësojnë. Nuk bie dakord me vendimin që, meqenëse nuk ka VKM, ne nuk po ua japim. Ne nuk kemi lidhje me VKM-në ta bëjë qeveria detyrën. Ne jemi Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ne kemi ligjin, do ta japim fondin edhe kur nuk e ka caktuar masën, do të ecim me hamendje. Qeveria, mund ta miratojë nesër VKM-në, çfarë do të bëjmë? Ne e miratuar këtu. Ne duhet t'i mbështesim, qeveria të vijë pas nesh. Nuk shkojmë ne pas qeverisë. Nuk mund të ndjekim ne ritmin që, nëse nuk ka VKM, nuk e japim. Kur të ketë VKM... Ligji thotë: përcakton masën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne do të ikim me propozimin e këtyre. Ta gjejë Ministria e Financave. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e kam personalisht. Ajo zonja atje përfaqëson një sigël, e cila nuk ka bërë detyrën për të bërë VKM-në.

Bashkim, ka dy vjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e propozon Ministria e Financave në Këshillin e Ministrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministria e Financave ka 2 vjet që nuk e ka bërë detyrën dhe ne t'i themi sot mos ia jep lekët. Jo ore le t'ua japë aq sa e kërkojnë ata deri ditën që do të bësh VKM-në, sepse, po e dha ligji, e ka dhënë Perëndia. VKM-ja është akt administrativ zbatues...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Bashkim, mos më ndërprit!

Ne nuk kemi rol formal këtu. Unë, ti dhe të gjithë kolegët, edhe pse jemi maxhorancë, e dimë që jo çdo kërkesë përmbushet. Këta mund të kërkojnë investime të ekzagjeruara, do t'i dëshironin më shumë se ju, por ne nuk jemi Zvicra, ne jemi Shqipëria me vështirësitë tona, ne duhet të ndajmë edhe kërkesat e pabaza. Ju ngriheni dhe thoni këtu vështirësi e administratës 50%. Është totalisht e pabazë, ligji nuk e ka dhe nuk e merr. Nuk e merr, duhet të kemi kurajën të themi që është e pabazë. Kjo është detyra jonë për ta thënë, por ama thashë nuk mund të bashkohemi me pjesën kur ata kërkojnë atë që ua kemi dhënë vetë me ligj tani dhe t'u themi, që ta shikojmë një herë rrugës. Duhet ta shikojmë sot. Ua thamë një herë në fillim që presim. T'i shikojmë të rejat, se nuk jeni kompletuar dhe ka logjikë financiare dhe unë kuptoj. Unë dhe kolegu Fino jemi në këtë Komision Ligjesh, por jemi edhe financierë dhe logjikën juridike e lidhim me logjikën fiskale. Pra, nuk do të kishte sens atëherë dhe nuk ishin plotësuar. Kot që ua jepnim, sepse do të digjen fondet. Por sot që thonë e kemi organikën, kërkojmë zbatimin e ligjit. Ne nuk mund ta diskutojmë fare dhe duhet t'ua japim.

Ju kërkoj ndjesë. Ju u gjendët këtu dhe juve ju drejtova, por të gjitha institucioneve që u diskutohet buxheti në Komisionin e Ligjeve, ashtu siç janë një sërë institucionesh të tjera, që nuk hyjnë në diskutim, është detyrë e komisioneve të tjera të adresojnë problematikat e tyre, ndryshe për çfarë jemi ne këtu. Ne nuk po i ngremë për vete.

Të nderuar kolegë deputetë, kur erdhi puna me populizëm le të themi mjeranë, deputetët e Shqipërisë dy legjislatura më parë dhe tashmë nuk kanë as shoferë, nuk kanë as zyra. Por nuk po kërkojmë për vete dhe unë nuk po e ngre zërin për deputetët, po e ngre për çdo gjë që shkruhet në ligj. Edhe për deputetët është e shkruar në ligj, për shembull, zyrat por nuk e zbatojnë. Atëherë, mirë për ne, sepse, po ta zbatojmë për ne, ngrihen me vrap populizmat, duke thënë këta i miratojnë për vete dhe as për pagat, sepse ne jemi paga e 800 në nivel hierarki. Janë 800 e ca zyrtarë që marrin pagë më të lartë se deputetët, nuk ka xhelozsi këtu. Këtu ka njerëz nga ne që e kanë ndarë mendjen për të bërë detyrën ndaj njerëzve, duke i paguar edhe gjërat nga xhepi apo nga bizneset e tyre, por te këto organet ne duhet të mos cedojmë asnjë qindarkë. Ua dha ligji, ne duhet të japim çdo gjë. E thashë çdo kërkesë që ka lidhje me statusin, ka lidhje me pavarësinë. Unë këtu po flas si jurist. Nuk mund të gjykojmë tani se ka një

institucion, do t'ia japim KLGJ-së, KLP-së dhe KPA-së cilësdo që ka mungesa në personel, që ka lidhje me statusin, duhet t'ia plotësojmë një orë e më parë. Para ka qeveria. Tek e fundit, të heqim diku tjetër, të heqim një investim. Kjo është reforma kryesore, duhet ta bëjmë sa më shpejt dhe nuk duhet të lëmë asnjë rezervë. Ne jemi ballëlartë. Këtë reformë e kemi bërë ne. Këtë reformë e kemi financuar ne si maxhorancë. Prandaj duhet t'i përgjigjemi deri në qindarkën e fundit ne si maxhorancë. Gjithë pjesa tjetër ka qenë kundër. Sot nuk ka moral njeri të ngrejë zërin për këto institucione në këtë aspekt, sepse nuk e ka dashur ekzistencën e kësaj reforme, që do të thotë se nuk e ka dashur ekzistencën e këtyre institucioneve. Por ne që e kemi dashur me shpirt në emër të shqiptarëve dhe e kemi bërë, kemi moral të kërkojmë plotësimin e çdo qindarke. Kaq kisha.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Në fakt, pa dashur ta zhbëjmë rëndësinë e këtij buxheti, absolutisht qeveria shqiptare e ka bërë detyrën siç duhet dhe nuk mundet që në një seancë të diskutimit të buxhetit në Komisionin e Ligjeve të bashkohem përsëri me mendimin e zotit Fino, që të merremi dhe të trajtojmë problemet e strukturave të institucioneve. Nuk jemi sot këtu për strukturë kuptojeni. Strukturat tuaja i ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë me vendim. Ne sot jemi për të plotësuar nevojat buxhetore në përputhje me ato struktura që keni. Të jem i qartë për këtë, 6,6% është buxheti i qeverisë shqiptare në rritje për vitin 2020 për organet e reja të sistemit të drejtësisë. 73,1% me rritje vjen buxheti i KLP-së po me rritje vjen buxheti i KLGJ-së. Sigurisht, edhe organet e vetingut në dinamikë për gjatë gjithë vitit 2019 keni sjellë pafund kërkesa, por mos harroni se nuk është në tagrin e institucioneve që ju drejtoni, të mblidhni mbledhjet dhe të na impononi ne si Kuvend strukturat. Ashtu si në një rast e ka bërë, edhe pse e ka në ligj, Gjykata Kushtetuese. Përsëri Kuvendi nuk mund t'i shkojë vendimit të mbledhjes së Gjykatës Kushtetuese, që thotë: “Unë dua 72 veta personel për vitin 2020”. Jo, qeveria ka portofolin. Sigurisht, Kuvendi i Shqipërisë, kur voton buxhetin në parim, orienton se cilat politika do të buxhetojë më shumë dhe cilat politika të qeverisë do të buxhetojë ndryshe. Edhe një herë, sot nuk jemi këtu për strukturat. Kuptojeni! Jemi për buxhetin. Gjatë gjithë vitit buxhetor keni rakorduar me Ministrinë e Financave dhe në Komisionin e Ligjeve të Kuvendit. Sigurisht, adresohen ato nevoja buxhetore, që nuk janë arrë në konsideratë dhe për Komisionin e Ligjeve janë esenciale. Nuk besoj. Është elementi i statusit, edhe trajtimi i nëpunësit. Por nuk mendoj se një anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor e kështu me radhë e ka lënë pa kryer detyrën funksionale mospasja e makinës dhe e shoferit. Nuk

mendoj kështu. Po, ua kemi dhënë me ligj. Patjetër që do ta marrin. Po ua kemi dhënë me akt nënligjor, patjetër do ta marrin, por me radhë.

Zoti Fino pak më parë tha se jemi të gjithë shqiptarë. Patjetër, në portofolin e buxhetit të shtetit kërkojnë të gjithë dhe ai që pret ndihmën ekonomike të portofoli i buxhetit të shtetit pret. Gjithsesi, me institucionet dhe me organet e vetëgjatë vitit 2019 kemi pasur dy probleme dhe unë gjej rastin, sepse janë dy probleme që i kanë adresuar secili institucion ndarazi, KPP-ja ndarazi, Komisioneri Publik ndarazi, Kolegji i Posaçëm i Apelit ndarazi. E gjitha kjo vjen nga neni 29, pika 5, i ligjit. Ne me reformën në drejtësi kemi vendosur që ju si organe të vetëgjatë të keni një trajtim financiar ndryshe, sistemi i drejtësisë të ketë një trajtim financiar ndryshe. Ne kemi pranuar, është politikë e kësaj qeverie zbatimin e reformës në drejtësi, por në fund të ditës, të nderuar kolegë, keni aplikuar që të gjithë me dëshirë për të shkuar aty. I keni pasur në konsideratë edhe vështirësitë e detyrës që keni marrë përsipër të kryeni. Asnjëri këtu ku jemi, nuk na kanë sjellë me zor.

Tani, zonja Mulaj, dy elemente ka neni 29, pika 5, dhe do të marrë zgjidhje, por jo zgjidhje siç e doni ju, por siç e ka ligji. Këshilltari ligjor dhe ekonomik përfiton përkatësisht 80% të pagës mujore përkatëse të institucionit të rivlerësimit. Elementi i parë. Ajo që ju keni kërkuar dhe, nëse jam i qartë se kam lexuar mbi 30 letra që kanë ardhur nga organet e vetëgjatë, duke qenë se vjetërsia në punë është element individual i pagës të gjithsecilit, ju keni kërkuar të qartësohet 80% plus vjetërsi në punë, sepse 80%-shin e ka dhënë ligji. Pra, 80% e pagës së Komisionerit. Këshilltarët ligjorë, nuk marrin vështirësi në punë, sepse u është përfshirë te ky 80%-shi i pagës së Komisionerit.

Së dyti, përfitimi i pagesës shtesë për shkak të vështirësisë, patjetër si me çdo institucion tjetër edhe me organet e vetëgjatë duhet të dalë ajo VKM-ja që tha kolegu Fino. Pra, të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, si do të shpërblehen punonjësit që punojnë, ata që janë të përgjegjshëm në detyrë dhe ata që nuk kanë të njëjtin rendiment pune me kolegun tjetër. Po këtë e bëni ju, nuk bëjmë ne. Ne kemi për detyrë, pra qeveria të nxjerrë vendimin përkatës një orë e më parë. E kemi diskutuar dy muaj në verë me Ministrinë e Financave. Të zgjidhet ky problem. Kanë ngarkesë të madhe këshilltarët në KPK, në KPP- dhe në KPA, detyrën bëjnë, por këto që u kemi dhënë. Të marrin më shumë se çka ligji, nuk do të marrin. Të zërthehet neni 29, pika 5. Ministria e Financave ka marrë orientim për vështirësinë, aty ka këshilltarë që u fillon vështirësia nga 7 vjet, ashtu siç ka këshilltarë që kanë 25 vjet. Elementi i vjetërsisë në pagë të trajtohet siç trajtohet për të gjithë nëpunësit e tjerë të shtetit. Nuk mundet që njeri që ka 7 vjet punë të marrë të njëjtin koeficient vjetërsie në punë si me atë që ka 25 vjet. Nuk mundet. Kjo është barazi. Njëri që shkon te institucioni me 7 vjet vjetërsi

pune, ta zgjidhë Ministria e Financave këtë dhe shpejt. Ndërsa çështja e shpërblimit për vështirësi të dalë me VKM-në përkatëse. Gjë tjetër nuk merrni në këtë komision. Pse? Nuk mund ta shkelim ligjin, për sa kohë kemi këtë ligj. Nëse do të ndryshojmë ligjin, është çështje tjetër. Sot kemi këtë ligj. A ka vështirësi? Patjetër që ka vështirësi funksionimi i institucionit. Edhe për çështjen e personelit që ju ngritët shqetësimin që vijnë dhe largohen nga puna për shkak të trajtimit jo të duhur financiar, nëse e kam kuptuar drejt, (pra largohen njerëz për shkak të trajtimit jo të duhur financiar. Këta njerëz që vijnë dhe largohen për këtë gjë), është mirë të na informoni si Komision Ligjesh, sepse këtyre njerëzve nuk duhet t'u hapet dera në këto institucione. Fare! Janë njerëz që vijnë aty te ju, marrin certifikatën e sigurisë, për shkak të specifikës që ka natyra e institucionit, dhe pas dy muajsh largohen.

Argumenti se nuk trajtohen mirë financiarisht, është qesharak; nuk është argument. Kështu që unë me këto dy konstatime, deri në momentin e miratimit të buxhetit nën për nën në Kuvend, mendoj të ulemi me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe t'i adresojmë siç duhet në këtë fazë të diskutimit të buxhetit, ndërsa çështjet e strukturave nuk i përkasin kësaj tryeze. Ato i ka miratuar Kuvendi me vendim dhe është vendimi i Kuvendit që nuk preket sot. Çdo lloj vendimmarrjeje që bëjmë ne sot këtu nuk preket. Pse? Sepse numri i punonjësve, i miratuar në projektbuxhetin e vitit 2020, është 82 377 dhe sot këtu nuk jeni në kushtet për të kërkuar as shtimin e numrit të punonjësve, as ndryshimin e klasës së pagës, as të funksioneve. Sot keni ardhur për nevojat buxhetore që keni për t'i bërë sa më funksionale organet që ju drejtoni, por edhe për të kërkuar një më një, pse jo, ato që ju garanton ligji.

Meqenëse zoti Fino erdhi, edhe unë e kam diskutuar edhe paraprakisht. Për nenin 29, pika 5, unë kam dy gjëra për të qartësuar edhe vetë, sepse kemi qenë vazhdimisht në kontakt: se si do të trajtohet dhe do të adresohet çështja e vjetërsisë në punë të këshilltarëve, por edhe e personelit tjetër poshtë (por kam përshtypjen se është vetëm për këshilltarët) dhe si do të trajtohet shpërblimi për vështirësitë në punë.

Për shpërblimin për vështirësi zgjidhja është miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, ndërsa për elementin e vjetërsisë në punë, që është element i pagës dhe është individual, do të duhet të gjejmë formulën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se nuk kam nevojë as për mohime, as për pohime, se jam këtu për të zbatuar vetëm ligjin e shtetit!

Zoti Fino, këto dy elemente kam unë të paqartë për zbatimin e pikës 5 të nenit 29. Sa për të tjerat, i qëndroj deri në fund fjalës. Ky është buxheti i reformës në drejtësi. Me gjithë vështirësitë që ka sot shteti, janë gjetur lekët për ta çuar deri në fund zbatimin e reformës në

drejtësi. 1,1 miliardë shtesë është fondi në buxhetin e shtetit për reformën në drejtësi, pa u prekur ende shuma 300 milionë, që është nga fondi rezervë i qeverisë për institucionet e reja të drejtësisë, që janë në proces ngritjeje dhe që do të ngrihen shumë shpejt.

Unë nuk e di, Ministria e Financave, ka ndonjë gjë për të shtuar lidhur me këto dy çështje që kemi diskutuar vazhdimisht me KPA-në?

Vilma Çausholli – Ministria e Financave shprehet plotësisht dakord me çfarë u diskutua.

Ulsi Manja – Pra, që do t'i japim zgjidhje...

Vilma Çausholli – Me vendim të Këshillit të Ministrave...

Ulsi Manja – ...me vendim të Këshillit të Ministrave të dyja shqetësimeve që janë ngritur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

Vilma Çausholli – Po, kemi përgatitur edhe materialet përkatëse, që do të hidhen për diskutim.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

Zonja Mulaj, keni një konsideratë të fundit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju lutem, ndizeni mikrofonin! Në fakt, debati nuk ju përket vetëm...

Natasha Mulaj – Jo, jo, nuk do të bëj debat fare!

Ulsi Manja – Debati u bë në parim, duke qenë se janë të tria organet e vetingut tani për të adresuar nevojat buxhetore, por, ju lutem, ju mund t'i adresoni shkurtimisht ato dy shqetësime që keni si KPA, sepse për të tjerat diskutimi ishte në nivel parimi.

Natasha Mulaj – Në fakt, desha të sqaroj dy momente.

E para, ne nuk kemi abuzuar me buxhetin dhe ky është fakt. Nga mbledhja e gjyqtarëve nuk janë dhënë asnjëherë tri paga, të jeni të qartë për këtë, asnjëherë, por ashtu siç thotë zoti Fino, deri sot janë dhënë dy paga në vit! Madje, ligji nuk thotë: pagë, por pagesë shtesë për vështirësi sipas rastit. Por, sipas rastit, kush do ta japë këtë shtesë? Ne e shpërndajmë, ne gjyqtarët!

Mua ma akordon fondin, zotëri? Unë e shpërndaj. Në qoftë se abuzoj, mbaj përgjegjësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi në rregull? Në rregull.

Edhe tjetra, në mungesë të aktit nënligjor të qeverisë, ne jemi detyruar dhe kemi marrë vendim. Kjo është arsyeja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një vendim që të mos kalojnë.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Kur ta nxjerrin...

Bashkim Fino – Unë jam në krahun tënd.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti nuk mund të thuash se do të marrësh shpërblim kur nuk e ke aktin nënligjor. Pra, duhet të jetë akti nënligjor. Më kuptoni drejt, nuk kam gjë me ju personalisht. Unë jam me ju. Unë jam relator...

(Deputeti Fino vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Ju e dini se si kanë punuar këshilltarët...

Natasha Mulaj – Unë jap edhe një sugjerim, zoti kryetar: në qoftë se formohet një akt që në mënyrë taksative këshilltari do të marrë çdo muaj 1%... Unë po e mbroj buxhetin e shtetit. Nuk dua absolutisht të...

Ka pasur raste që mbledhja e gjyqtarëve nuk u ka dhënë të gjithë gjyqtarëve shtesë për vështirësi, por i ka anashkaluar disa elemente që nuk i kanë dhënë... Kështu që unë po mbroj buxhetin.

Edhe ajo dhënia sipas rastit, nga Mbledhja e Gjyqtarëve, është në përputhje me ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Jam dakord, jemi në një gjatësi vale.

Natasha Mulaj – Jemi në të njëjtën linjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Fino që ta përmbysim buxhetin e KPA-së.

Bashkim Fino – Përmbysja është kjo: që të jemi korrektë, akti nënligjor mund të japë shumë sugjerime, si, për shembull, e një, dy ose tri paga, punë e tij se si e shikon ai anën financiare dhe e gjykon ai, por edhe mund t'jua lërë në dorë ju, drejtuesve kryesorë, jo të gjithë Kolegjit, sepse ti, në fund të fundit, je kryetarja që e drejton atë institucion dhe e di se cili këshilltar ose punonjës tjetër ka punuar dhe ka dhënë performancë që jo vetëm ty, por të gjithë ju ka ndihmuar.

Qeveria mund ta lërë krejt në dorën tuaj dhe, madje, duhet ta lërë në dorën e drejtuesve, jo në dorën e Kolegjit. Pra, nuk mund ta vendosin ata.

Shumën e vendos ajo, por e lë në dorën tuaj që të vendosni sa do të jetë shpërblimi. Unë për këtë jam, që të jetë sa më i rakorduar me vendim qeverie. Ama, të mbledhësh grupin tënd të gjyqtarëve dhe të thuash: do të jap dy paga, pavarësisht se unë thashë tri, dakord, paskeni

dhënë dy, e keni bërë gabim! Domethënë, duhet të mbështetet në diçka, ndaj edhe ngeleni dy muaj pastaj që nuk po merrni rrogat, pasi, duke e marrë nga fondi i pagave, ai është planifikim...

Të të them diçka, por nuk e kam për ju, e kam për ekonomistin. Artikulli “601” është pagë, pra nuk mund ta ngatërrosh me mallra dhe me artikullin tjetër, ndërsa artikulli “602” është shpenzime. Këto të dyja nuk mund t’i ngatërrosh, ti i di shumë mirë, si ekonomist. Kjo do të thotë që nga 601-shi do të marrësh dhe t’i japësh edhe pagën, edhe shpërblimin, ashtu siç tek artikulli “231” janë investimet dhe nuk e ngatërrosh dot, pra të marrësh nga lekët e investimeve dhe t’i japësh për pagë ose ta kesh për shpenzime operative. Këto janë të dhëna financiare që duhet t’i dinë të gjithë financierët dhe i dinë. Ky është thelbi i kësaj.

Në përfundim, zoti kryetar, unë mendoj që evidenca që ne kemi përpara ka rritje, pra në kuptimin e saj, por duhet të bëhet një përlogaritje në funksion të vendimit të qeverisë, përpara se buxheti të kalojë nën për nën, se në parim mund të kalojë, që edhe këta të kenë shifrat e sakta për projektbuxhetin e vitit 2020, të cilat ju takojnë edhe në bazë të nenit 29.

Ulsi Manja – Dakord.

Atëherë, jemi dakord, zonja Çausholli që, përpara kalimit nën për nën, të kemi dakordimin e shifrave të sakta të buxhetit për institucionin e KPA-së, pasi të dalë vendimi?

Biem dakord, kolegë?

Po, zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Dakord.

Biem dakord me zotin Fino dhe me Ministrinë e Financave? Dakord me projektbuxhetin e KPA-së, me një votë abstenim të zotit Zeneli.

Zonja Mulaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dritan Baji – Tani, meqenëse ne folëm shumë në parim dhe pak për buxhetin, domethënë ju po votoni diçka, për të cilën ne nuk arritëm as të shpreheshim tamam për kërkesat tona... Kryetarja foli pak në parim, por nuk është se ne hymë brenda buxhetit.

Lidhur me pikat që përmendi zoti Fino për kërkesat që, në gjykimin tonë, janë të arsyeshme dhe i kemi bërë ne për vështirësinë ose ndryshimin e masës së vështirësisë së gjyqtarëve, apo edhe shtesën për punonjësit e administratës, ato nuk janë përfshirë në projektbuxhetin e vitit 2020; ato janë disa kërkesa, në gjykimin tonë, të arsyeshme, të cilat i kemi sjellë për t’i shtruar para jush. Domethënë, i gjithë diskutimi që bëhet ose projektbuxheti nuk është ndërtuar mbi ato efekte.

Për sa i përket vështirësisë së punës së këshilltarëve, ramë të gjithë dakord që duhet dhënë me një akt nënligjor. Ne nuk kemi bërë asgjë më tepër, veçse e kemi përlogaritur këtë efekt në tabelat e llogaritjes për sa u përket pagave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Personalisht jam mbështetur te vendimi që ka marrë mbledhja e gjyqtarëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ai nuk është në kundërshtim...

Bashkim Fino – Në kundërshtim është, sepse të drejtën e ka qeveria, nuk e ka ajo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po ta them troç.

Dritan Baji – Aty nuk specifikohet që të drejtën e ka qeveria, pasi thuhet: rast pas rasti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Jemi të dy ekonomistë dhe nuk kuptohemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dritan Baji – Edhe unë po bie dakord me ju në këtë pjesë, por ideja është që ne po shkojmë përsëri drejt atij përfundimi.

Bashkim Fino – Jo, unë thashë tjetër gjë, që do të raportojmë dhe kemi kohë deri më 5 dhjetor, kur do të kalojë buxheti në parim, madje kemi kohë edhe deri më **19 dhjetor**, kur do të kalojë nen për nen (dhe nen për nen është momenti kur bëhet korrigjimi i nevojshëm për ato që kërkon ti) dhe themi: ju keni një numër të caktuar në strukturë...

(Deputeti Fino vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Dritan Baji – Pikërisht.

Bashkim Fino – Numrin e caktuar, me pagën që keni ju, do ta merrni, plus edhe vendimi i qeverisë, që duhet të dalë brenda këtij muaji që të llogaritet për të gjitha vitet dhe ti të jesh në rregull me fondin e pagave.

Dritan Baji – Jo, unë jam dakord në këtë pjesë, ndërkohë që them se këtë gjë kemi bërë: kemi llogaritur (ndoshta në gjykimin tuaj, para kohe, në mungesë të aktit nënligjor) pikërisht këtë pjesë. Nuk ka ndonjë gjë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Pse këmbëngul? Mos më injoro!

Këmbëngul, sepse ti e ke llogaritur me dy paga, dakord?

Dritan Baji – Me tri paga.

Bashkim Fino – Me tri paga. Kush ta dha të drejtën ta llogarisësh me tri paga? Po sikur qeveria të thotë: do të jap pesë paga? Po sikur qeveria të thotë: do të jap dy paga, sepse nuk kam të jap tri paga? Ti do të japësh dy, aq sa të japë qeveria; aq mundësi financiare ka!

Dritan Baji – Por ju thatë...

Bashkim Fino – Të lutem, të lutem! Kjo do të thotë se përllogaritja që ke bërë ti, është në ajër, sepse është e pambështetur; këtë jam duke të thënë! Kuptoje këtë gjë, në mënyrë që të vazhdojmë më tej diskutimin. Po nuk e kuptove këtë, kot që flet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky thotë: unë e kam llogaritur me tri paga dhe dua atë që kam llogaritur unë. Domethënë, ky ia imponon qeverisë dhe thotë: e llogaritëm, ndaj më nxirr një akt nënligjor që të jetë me tri paga. Po qeveria mund të japë pesë, sepse ka mundësi financiare të japë pesë paga shpërblim. Çfarë bëhet? Do të thuash që është bërë llogaria gabim?

Dritan Baji – Jo, qeveria ka dhënë pesë, por mbledhja e gjyqtarëve te ne ka rënë dakord që të mos marrim më shumë se tri, edhe në qoftë se qeveria ka dhënë pesë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, e para, ai vazhdon, sepse ai e ka zëvendësuar vendimin e qeverisë me vendimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve dhe në të vetën është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por nëse nesër qeveria në atë VKM do të përcaktojë që nuk do të jenë tri paga, por do të jetë një, i bie që një pagë, të cilën e kanë marrë, kur të shkojë Kontrolli i Lartë i Shtetit, të kthehet mbrapsht. Kjo është e gjitha. Gjithsesi, kjo është një çështje që do ta rakordoni me Ministrinë e Financave dhe do ta zgjidhni përfundimisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dritan Baji – Në qoftë se e quajmë të ezauruar pjesën e pagave, ne kemi bërë kërkesë edhe për investime. Një investim i vetëm, po themi, që është relevant, është për një pajisje skaner kontrolli në hyrje të institucionit.

Institucioni i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit zhvillon seanca publike, ku hyrja është e lirë për publikun. Madje, edhe për efekt të sigurisë, është kërkuar gjithmonë nga Garda e Republikës që të ketë një pajisje...

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Keni ndonjë gjë tjetër?

Dritan Baji – Është bërë një përllogaritje rreth 12 milionë e 700 mijë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të rinj.

Është skaner, pajisje për të kaluar poshtë. Ky ka qenë fond i akorduar në vitin 2018. Ne e kemi deleguar prokurimin te Ministria e Brendshme, por atje nuk është arritur të bëhet prokurimi, për mungesë asokohe të stafit e të tjera.

Natasha Mulaj – Nuk është për fajin tonë.

Dritan Baji – Në vitin 2019 ky fond u anulua.

Ulsi Manja – Zoti Fino, me sa kuptoj unë, kur erdhëm në termat konkretë të diskutimit të buxhetit të KPA-së, e vetmja kërkesë për nevojë buxhetore këtu është për një skaner, ndërkohë që dy problemet e tjera, që kanë të bëjnë me trajtimin financiar të këshilltarëve, nuk lidhen me nevojat buxhetore.

Dritan Baji – Gjithnjë në qoftë se do të bëhen saktësimet që folëm.

Ulsi Manja – Pra, gjithmonë me mendimin dhe me sugjerimin e kolegut Fino që vendimi i Këshillit të Ministrave t'i zgjidhë të dyja këto problematika që ju ngritët. Pra, e vetmja kërkesë juaja këtu është një skaner për efekte sigurie për zhvillimin normal të gjykimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

Nuk e di, zoti Fino, paska qenë fond i miratuar, por ju ia keni kaluar Ministrisë së Brendshme, Gardës së Republikës, për ta tenderuar këtë. Nuk është bërë ende. Ministria e Financave ka dijeni për këtë?

Vilma Çausholli – Me thënë të drejtën, nuk e kam këtë informacion.

Nëse e ka pasur Ministria e Brendshme, duhet të diskutojmë me këtë ministri pse nuk është bërë.

Ulsi Manja – Atëherë, nëse mund ta mbani shënim, nuk e di, do të vijë këtu Ministria e Brendshme për buxhetin, për shkak se ne jemi komision përgjegjës për pushtetin vendor dhe administratën publike. Pra, ta mbajmë shënim këtë fakt dhe të shohim mundësinë se si mund ta bëjmë kalimin e fondit. Nëse nuk e bon dot Ministria e Brendshme, le ta bëjë Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Po nuk e bëri dot kjo e fundit, ta bëjë Ministria e Brendshme. E rëndësishme është që të zgjidhet problemi; ky është shqetësimi.

Dakord, kolegë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë faleminderit, zonja Mulaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Natasha Mulaj – A mund të shtoj edhe diçka?

E di se e keni kohën të kursyer, edhe ne atje, por...

Ulsi Manja – Po, mund të shtoni diçka.

Natasha Mulaj – ...ka një problem këtu. Ju vërtet ma pretë muhabetin për sa i përket strukturës, por unë kam nevojë për kabinet.

Ulsi Manja – Nuk është tani struktura, në kuptimin që nuk është pjesë e këtij debati. Strukturën do ta shihni me zotin Fino dhe me Ministrinë e Financave. Mund ta diskutojmë pas miratimit të buxhetit, sepse ka edhe mënyra të tjera me Ministrinë e Financave se si mund të adresohen shqetësimet që keni në strukturë. Por duhet të bindet një herë Kuvendi për strukturën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, duhet të bindet Kuvendi, pastaj të shohim mundësinë e buxhetimit të ndryshimeve që do t'i bëjmë strukturës.

Unë jua thashë që në fillim se për çfarë u mbledhëm sot: për nevojat buxhetore për vitin 2020, sa janë akomoduar nga Ministria e Financave dhe çfarë mbështetjeje kërkon nga Komisioni i Ligjeve.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Natasha Mulaj – Faleminderit juve!

Ulsi Manja - Vazhdojmë me institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Prezente kemi zonjën Genta Tafa (Bungo), kryetare; zotin Agim Paskali, drejtor Ekonomik, dhe zonjën Albana Pulaj, drejtoreshë Juridike.

Zonja Bungo, mirë se keni ardhur në komision!

Në fakt, disa nga nevojat e institucionit tuaj na janë parashtruar në mënyrë dinamike përgjatë vitit buxhetor 2019, por ka ardhur edhe një material tjetër, që unë ia kam kaluar kolegut Fino për ta pasur në konsideratë gjatë diskutimit të buxhetit.

Sot jemi këtu për tri gjëra: cilat kanë qenë nevojat buxhetore që ju i keni kërkuar Ministrisë së Financave për t'jua akomoduar për vitin 2020; sa prej këtyre nevojave buxhetore janë marrë në konsideratë dhe çfarë nuk është marrë në konsideratë? Çfarë kërkon sot nga Komisioni i Ligjeve?

Fjala është për ju.

Genta Tafa (Bungo) – Ju falënderojmë shumë dhe ishim shumë të vëmendshëm gjatë gjithë diskutimit që u bë me Kolegjin e Posaçëm të Apelit!

Meqenëse ne jemi institucione të ngjashme, kemi pak a shumë të njëjtat probleme. Ndërkohë, në raport me çfarë ne kemi kërkuar, si Komision i Pavarur i Kualifikimit, ndryshimi ndërmjet asaj që ne kërkojmë dhe asaj që është parashikuar nga Ministria e Financave qëndron vetëm në zërin e pagave, ku problemi është thjesht dhe vetëm për efekt të vjetërsisë dhe të vështirësisë së këshilltarëve.

Në lidhje me vjetërsinë, do të doja të ishim pak të qartë: këshilltarët tanë paguhën, në bazë të ligjit, me 80% të pagës G-III. Unë nuk jam ekonomiste, por paga G-III, me sa di unë, ka edhe elementin vjetërsi për të gjithë komisionerët, gjë që llogaritet 15 vjet eksperiencë pune, megjithëse unë kam 25 vjet, pra nuk është e thënë që të paguhesh për vjetërsinë, gjithmonë në bazë të viteve të eksperiencës që ke. Në këto kushte, për këshilltarët tanë jo vetëm që nuk janë llogaritur pagat me vjetërsinë sipas ligjit, pra me G-III-shin tonë, por nuk është llogaritur as me vështirësinë që parashikon Kodi i Punës. Pra, nuk kanë fare vjetërsi. Në njëfarë mënyre, ajo që ne kemi kërkuar vazhdimisht dhe vazhdojmë ta kërkojmë është të kenë edhe ata të drejtën e përfitimit, që ua njeh ligji për vjetërsinë. Pastaj, nëse do të llogaritet me 15-vjetëshin tonë apo me vjetërsinë e tyre reale, kjo për ne është një gjë që nuk ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flasim tani për vështirësinë, për të cilën unë nuk jam fare kundër asaj që të ketë një vendim qeverie duke përcaktuar një normë për vështirësinë, për të cilën do të paguhën këshilltarët tanë. Unë nuk e detyroj dot qeverinë që të nxjerrë një vendim (normalisht duhej të ishte bërë), por mua më shqetëson se në asnjërin pikë të ligjit tonë nuk kam gjetur bazën ligjore që e autorizon qeverinë të përcaktojë një marzh për vështirësinë e këshilltarëve (nuk më ka rezultuar).

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse, normalisht, qeverinë duhet ta autorizojë ligji për të nxjerrë një vendim të tillë.

Ndërkohë, ne i kemi pasur gjendje në buxhet dhe u kemi dhënë një pagë vështirësie këshilltarëve tanë. Ndoshta mund të jetë një vizion si këshilltar i një punonjësi në administratë, por këshilltarët te ne janë ata që mbajnë një barrë pune tejet të madhe. Orari, të paktën në institucionin tim, është një koncept i panjohur; pra tetorëshi nuk ekziston.

Duke qenë se Ministria e Financave nuk na ka dhënë asnjëherë mundësinë dhe nuk na ka lejuar që ne t'i paguajmë ashtu siç u takon me Kod Pune orët e punës jashtë orarit, sepse, meqenëse ata quhen këshilltarë, i konsideron si politikë dhe ata nuk duhet të paguhën për orët jashtë orarit, unë dhe të gjithë kolegët e mi, pra Komisioni, që me ligj administron buxhetin që na jep Kuvendi, kemi vendosur që t'u japim pagesën ligjore një pagë për vështirësi.

Deri tani kanë marrë një pagë.

Vështirësia në të cilën u ndodhëm sivjet në buxhet nuk erdhi për shkak të kësaj pagese, por për shkak të mungesës së kalkulimit të vjetërsisë në punë të këshilltarëve, ndërkohë që për zërat e tjerë, me sa di unë, edhe nga drejtori Ekonomik dhe drejtoresha Juridike, nuk është se kemi probleme me Ministrinë e Financave. Ne kemi bërë një kërkesë, të cilën unë e kam shumë të qartë që nuk mund të jetë në axhendën e kësaj tryeze, ndaj nuk po hyj fare në diskutimin e

saj. Por këto dy pika për këshilltarët, që për ne janë element kyç i punës, dëshiroja t'i thosha dhe prandaj i thashë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Fino, meqenëse zonja Bungo, ç'është e vërteta, na e lehtësoi paksa punën, edhe unë jam plotësisht dakord, madje besoj se ishim në të njëjtën gjatësi vale edhe me kolegun Fino që vjetërsia, si element i pagës, do të duhet të zgjidhet për të gjithë nëpunësit e shtetit, pra jo vetëm për këshilltarët e KPK-së, komisionerit publik apo kolegjit të posaçëm të apelimit.

Të gjithë kanë të drejtën të përfitojnë elementët e vjetërsisë në punë, pastaj masa se si do të jetë trajtimi për vjetërsinë në punë është çështje tjetër.

E dyta, ka të bëjë me pagesën shtesë për vështirësi sipas rastit, thotë ligji. Jo domosdoshmërisht mund të marrësh, sepse mund të dalë VKM-ja nesër dhe mbledhja e komisionerëve të KPK-së mund të vendosë që nga 12 këshilltarë të shpërblejë vetëm 3.

Tani ju thoni se kush e autorizon qeverinë ta nxjerrë këtë VKM dhe të përcaktojë nivelin e pagave. Qeverinë e autorizon neni 19/1 i ligjit “Për organet e rivlerësimit”, sepse thotë se “buxheti i institucioneve të rivlerësimit financohet nga buxheti i shtetit, në të cilin ato pasqyrohen si institucione të veçanta”.

Ndërsa, pasi të dalë VKM-ja e qeverisë, ty të autorizon neni 19/3 që e zbaton në mënyrë të pavarur buxhetin që të është akorduar. Unë mendoj që janë të gjitha mundësitë për të adresuar si duhet nenin 29/5 të ligjit, që të mos kemi paqartësi në zbatim, sepse, edhe nëse ju keni vendosur të jepni një pagë shpërblim këshilltarëve për shtesë vështirësie dhe KPA-ja 2, me sa tha drejtori ekonomik, absolutisht ju keni zëvendësuar VKM-në që qeveria nuk e nxori, e keni zëvendësuar me vendimmarrjet respektive të mbledhjeve që keni bërë.

Gjithsesi kjo nuk është çështje për ta diskutuar sot, por unë dua të më sugjerohet një zgjidhje që bashkërisht, përpara se ta votojmë buxhetin, edhe nen për nen në Kuvend, të kemi një zgjidhje për të dy shqetësimet që ngriti zonja Bungo, për vjetërsinë e komisionerëve, e këshilltarëve dhe për shpërblimin për vështirësi.

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino - Faleminderit!

Ju e trajtuat saktë problemin dhe lexuat nenin 19 të ligjit, madje, me dashje apo pa dashje, harruat të lexonit pikën 4 të nenit 19.

Unë po e lexoj pikën 4, për t'i bërë edhe një pyetje drejtorit ekonomik: “Institucionet kanë të drejtë të përdorin të ardhura dytësore, të përfituara nga projektet ndërkombëtare, donacionet, botimet e të tjera.

A i keni përdorur këto të ardhura dytësore për vitin 2019 (gjithmonë nëse i keni krijuar, se edhe mund të mos i keni krijuar dhe s'doni t'ia dini dhe mbështeteni te pika 5 e nenit 29)?

Këtë e kisha edhe pak me humor, në fakt, se po të lexosh ligjin tamam, i nxjerr zbuluar këta nganjëherë, pavarësisht se janë juristët më të mirë që kemi.

Ligji nr.10405 është ligji ku përfshihen pagat dhe shpërblimet në Republikën e Shqipërisë. Ky është një ligj që detyron KM-në për të nxjerrë edhe aktet nënligjore në funksion të tij, se i takon qeverisë të nxjerrë aktet nënligjore.

Ne na takon që ta trajtojmë dhe ta ndjekim çështjen e vjetërsisë dhe të vështirësisë, që këshilltarët dhe gjithë punonjësit e tjerë t'i gëzojnë këto të drejta, megjithëse ka një diskutim teknik, por nuk ia vlen ta bëj se i kalon caqet e performancës së komisionit, por vjetërsia është 80% të G3-shit dhe këtu pastaj lind vështirësia e vjetërsisë që ka cdo këshilltarë, por, në fakt ligji e ka thënë se merr 80% të pagës së gjyqtarëve. Këtu është një handicap midis 80%-shit të gjyqtarëve (gjithmonë flasim për këshilltarët). Të sqarojmë edhe një herë, nuk flasim për trupën funksionale që po bën vetingun, por po flasim për trupën ndihmëse, që edhe ajo është shumë e rëndësishme. Pra, këta vijnë e kërkojnë këtu shtesa, qoftë në organikë po në paga dhe shpërblime për pjesën ndihmëse, duhet ta kuptojmë këtë që të jemi të qartë. Nga pikëpamja politike unë mund të them se funksionaliteti i institucionit është normal, me këtë buxhet që është paraqitur. Nga pikëpamja e shifrave unë mendoj se jemi në rregull, madje mund të them se investimet në vitin 2019 kanë qenë 4 milionë dhe ju deri në fund të 10-mujorit keni realizuar 2 milionë e 900 mijë, pra keni akoma edhe 1 milionë e 100 mijë të tjera, që besoj se do t'i realizoni dot për 2 muaj, ndërkohë që planifikimin për vitin 2020 e keni vënë rreth 4 milionë lekë. Kështu që, në qoftë se e zgjidhim këtë çështje, që të dalë akti nënligjor i qeverisë pa lënë ekuivoke, por t'i zgjidhë të gjitha saktë dhe drejtë. Besoj se nuk kemi probleme me shifrat për të kryer funksionalitetin e institucionit për të cilin është krijuar.

Siç e theksova edhe në fillim, gjithë institucionet e pavarura, gjithë institucionet e drejtësisë kanë një buxhet të kënaqshëm, super të kënaqshëm, 1,1 miliardë lekë dhe, përvec kësaj, qeveria ka edhe një fond rezervë prej rreth 300 milionë lekësh edhe për institucionet e tjera që mund të krijohen në funksion të kësaj, si SPAK-u, Byroja e Hetimit e të tjera me radhë, por edhe për ju. Kjo do të thotë që, edhe nëse aktin nënligjor për një apo dy arsye nuk del në dhjetor, por del në janar apo në shkurt, prapë fondet, edhe sikur të miratojmë këtë buxhet që kemi sot, janë aty, pra ka fonde rezervë për institucionet e drejtësisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Problemi është që të zgjidhim elementin e vjetërsisë për këshilltarët dhe shpërblimin për vështirësi, sipas rastit, siç e thotë ligji.

Ministria e Financave të ulet, të sjellë zgjidhjet e këtyre dy komponentëve të rëndësishëm që lidhen me trajtimin financiar të trupës ndihmëse të KPK-së dhe ne t'i adresojmë si duhet përpara votimit nen për nen të buxhetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Besoj se këtu biem dakord.

A ka gjë tjetër? Nuk ka.

Shumë faleminderit zonja Bungo, që na e lehtësuat, në fakt, punën!

Ditë të mbarë!

Ulsi Manja - Vazhdojmë me dëgjuesën e fundit për sot, me institucionin e Komisionerit Publik. Këto komisionerët janë hallkë shumë e rëndësishme në zinxhirin e vetëingut.

Kemi prezentë sot, zotin Florian Ballhysa, komisioner publik, zotin Darel Sina, komisioner publik dhe zonjën Alketa Çeli, kancelare.

Mirë se erdhët në komision!

Edhe për ju, si për dy institucionet e tjera, vlen i njëjti rregull. Cilat janë nevojat që keni parashtruar? Sa janë akomoduar nga Ministria e Financave në projektbuxhetin e vitit 2020. Çfarë i kërkohet komisionit përgjegjës!

Urdhëroni, zoti Sina!

Darel Sina – Faleminderit, zoti Kryetar!

Për sa u përket dy pikave të konsumuara nga dy kolegët përkatësisht nga institucioni i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për vjetërsinë dhe pagesës shtesë ne jemi dakord me çfarë konsumuat, kështu që nuk dua të zgjatem më shumë. Jam dakord.

E vetja gjë që po e lexoj është sipas zërave buxhetorë, projektbuxheti i propozuar i mbulon të plotë nevojat e institucionit për shpenzime kapitale shpenzime për mallra dhe shërbime, por nuk ka parashikuar të plotë fondin e nevojshëm për shpenzime personeli, paga dhe sigurime shoqërore, duke bartur të njëjtat problematika të hasura gjatë vitit 2019.

Institucioni i Komisionerit Publik e nisi punën e tij me 26 punonjës. Me një vendim tuajin ky numër shkoi në 30, çka presupozon që buxheti duhet të rritet. Fakti është që buxheti i Komisionerit Publik nuk pati këtë reflektim në buxhetin e ri. Prandaj do t'ju lutesha ju si komision ta merrni në konsideratë këtë fakt dhe ky ndryshim të pasqyrohet në buxhetin e vitit 2020.

Unë nuk kam asgjë tjetër për të shtuar. Jam i hapur për pyetje nga ana juaj.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Sina!

Zoti Ballhysa, e keni për të shtuar diçka?

Florian Ballhysa – Faleminderit, i nderura kyetar!

Komisioneri Publik ka një eksperiencë të mirë me Komisionin e Ligjeve për shtimin e strukturës që u bë vitin e kaluar, ku u shtua struktura e njësisë ligjore, e cila është muskuli i të tre institucioneve, prandaj edhe të tre këto institucione shoh me kënaqësi që kërkojnë që ta incentivojnë punën në këto struktura.

Në mbledhjen e fundit për projektbuxhetin e vitit 2019 të zhvilluar në tetori të vitit të kaluar (në mos gaboj) u ra dakord që me Ministrinë e Financave të rakordohej për rritjen e buxhetit të institucionit për shkak të shtesës së strukturës.

Ju jeni në dijeni që nga dhjetori i kaluar deri pak ditë më parë ne kemi pasur një korrespondencë si me parlamentin, si me Këshillin e Ministrave, ashtu edhe me Ministrinë e Financave, për efekt të transparencës, edhe me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit në lidhje me akomodimin e disa nevojave financiare. Ne kërkojmë që kjo eksperiencë e këtij viti të merret parasysh në draftimit të buxhetit për vitin 2020. Bëhet fjalë për një fond 10 milionë lekë, që do të duhet të shtohet në zërat 600 dhe 601 të buxhetit të institucionit tonë, me qëllim që pagat dhe sigurimet shoqërore të 30 nëpunësve të Komisionerëve Publikë të gjejnë akomodim në fondin tërësor që do të duhet të miratohet nga Kuvendi.

Institucioni i Komisionerit Publik ka respektuar të gjitha procedurat që parashikon ligji nr. 84/2016, neni 19, e ka paraqitur projektbuxhetin si një institucion i pavarur kushtetues pranë Komisionit të Ligjeve, gjithashtu edhe pranë Ministrisë së Financave. Kemi zhvilluar takime, se nuk është hera e parë që ulemi me Ministrinë e Financave për projektbuxhetin, por ka ardhur momenti i një vullneti politik për të dhënë këtë mbështetje që kërkohet për garantimin e funksionimit të këtij institucioni të rëndësishëm në procesin e vetingut.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Duke i falënderuar të dy komisionerët dhe kancelarin. Nuk e kuptoj pse Ministria e Financave nuk e ka reflektuar këtë ndryshim në strukturë, të cilin e kemi bërë vitin e kaluar nga 26 në 30 punonjës. Absolutisht që kërkesa e tyre është e drejtë, sepse është Kuvendi që miraton strukturat dhe mbi këtë bazë qeveria dhe Ministria e Financave i zbatojnë ato, nuk ndodh e kundërta.

Së pari, unë do të kërkoja një sqarim nga Ministria e Financave.

Së dyti, pavarësisht sqarimit që ajo do të na japë, unë dua të pyes Ministrinë e Financave, që projektbuxheti për 600-601-shin, 57 milionë lekë për vitin 2020, a janë për 30 punonjës apo jo?

Në qoftë se nuk janë, absolutisht që duhet të bëhet një përllogaritje e saktë për 30 punonjësit e këtij institucioni.

Dua të sqaroj se investimet për këtë vit kanë qenë 1 milionë e 500 mijë dhe keni 4 milionë pa realizuar. Mbase i realizoni këto dy muaj. Dhe keni përsëri investime për këtë vit, rreth 1 milionë lekë të reja.

Unë kërkoj që në mënyrë absolute të vlerësohet nga Ministria e Financave dhe të na japë sqarim, edhe nëse është përllogaritur gabim, duhet të korrigjohet urgjent, sepse ne e kemi kaluar strukturën që vitin e kaluar.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Çausholli!

Vilma Çausholli – Faleminderit, zoti kryetar!

Struktura e parashikuar nga Ministria e Financave, e përllogaritur për vitin 2020 është me 30 punonjës. 30 punonjësit janë marrë të plotë dhe në total fondi i pagave dhe i sigurimeve, duke përfshirë ato dy çështjet që kemi diskutuar, është 56958.

Fillimisht, në fillim të vitit 2019 kemi pasur një pasaktësi, e cila ka ardhur si pasojë e leximit ndryshe të ligjit në lidhje me një shtesë, e cila tashmë është përfshirë në parashikimet që janë bërë për vitin 2020 për dy kryetarët e institucionit.

Kjo ka qenë një diferencë prej 1 milionë lekësh, që bën diferencën mes buxhetit të vitit 2019, plani fillestar, me planin fillestar të vitit 2020. Pra, korrigjimi është bërë, por fondi që është shtuar nga plani fillestar 2019 në planin fillestar 2020, ka reflektuar thjesht, jo vetëm numrin prej 30 punonjësish, por edhe një pasaktësi nga ana jonë për llogaritjen e një shtese për dy komisionerët.

Ndërkohë, lidhur me pjesën tjetër, 7 milionë, 9 milionë apo 10 milionë është çështje që do të përcaktohet kur të merret vendimi mbi masën e shtesës për vështirësi dhe për vjetërsinë e këshilltarëve.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Zoti Fino, dakord?

Bashkim Fino – Jam dakord. Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave po thotë që 57 milionë lekë që ti ke për vitin 2020 janë për 30 punonjësit, edhe pasaktësinë që ka ndodhur vitin e kaluar për pagesën e një komisioneri. Pra, në qoftë se ju jeni dakord me përgjigjen e

Ministrisë së Financave, 57-ta është në rregull dhe i mbulon të 30 punonjësit, paga plus sigurime shoqërore.

Çështja tjetër është se mbi këtë 57 do të ketë fond, do të jetë fondi që dalë nga aktin nënligjor.

Pra, ju a jeni dakord me këtë përgjigje se pastaj ne do t'i rakordojmë këto?

Ulsi Manja – Zoti Fino, unë propozoj që zonja Çeli me zonjë Çausholli ta rakordojnë këtë fakt në zërin përkatës buxhetor.

E rëndësishme është që paga plus sigurime shoqërore të jenë për atë strukturë që ka miratuar Kuvendi për vitin 2020 plus shtesën që do të vijë për shkak të atij akti nënligjor që do të nxjerrë qeveria.

A jeni dakord?

A ka kërkesa të tjera? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Florian Ballhysa, zoti Dariel Sina dhe zonja Alketa Çeli!

Ju ftoj të jeni në kontakt me Ministrinë e Financave!

Të nderuar kolegë,

Me këtë dëgjese e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Dua të falënderoj sinqerisht kolegët deputetë për durimin dhe seriozitetin!

Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj relatorin, zotin Fino, për trajtimin si duhet të buxhetit për vitin 2020 për institucionet kushtetuese.

Dua të falënderoj këshilltarët e komisionit, Isidën, por edhe këshilltarët e drejtorisë së Shërbimit të Monitorimit që ishin prezentë në pjesën e parë të mbledhjes.

Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë mediet për pasqyrimin korrekt dhe transparent të kësaj seance dëgjimore të projektbuxhetit 2020!

Nesër do të jetë grupi i dytë i institucioneve që do të dëgjohej në Komisionin e Ligjeve. Janë 9 institucione të tjera që do t'i dëgjojmë nesër.

MBYLLET MBLEDHJA